



# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 12(449)

DHJETOR 2025

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtör: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

## EDITORIALI

### PASLUFTA ËSHTË NJË HISTORI TJETËR



Nga Petro KOÇI

FAQE 3

## PROFILI

### PËLLUMB QAZIMI GJENERALI DHE DIPLOMATI PËR LUFTËN DHE SHQIPTARËT



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 6,7

## PORTRET

### VEFI... MISIONARIA



Nga Bashkim Koçi

FAQE 5

FEDERATA E VETERANËVE TË LUFTRAVE PËR LIRI E PAVARËSI TË POPULLIT SHQIPTAR BOTON DHE PROMOVON VEPRËN STUDIMORE SHKENCORE TË POLITOLOGUT, DIPLOMATIT DHE PUBLICISTIT KOSOVAR BASHKIM HISARI

# DEKODIMI I KRIMEVE...

## PROMOVIMI

### HALIL RAMA ËSHTË NJË NËPUNËS EKSELENT

Nga Irfan DASHI

FAQE 9

### SHPENDI TOPOLLAJ: HALIL RAMA NË 65 VJETORIN E TIJ TË LINDJES

FAQE 11

### ODA DIBRANE SI INSTITUCION VLERASH NË POEZINË E HALIL RAMËS

Nga Nexhbedin Basha

FAQE 8

### ISLAM VOKA: DEDIKIM PËR HALILI RAMËN

FAQE 11



TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU – Kryetare e OBVLP: Prej njëzet vitesh Bashkimi është zëvendësredaktor i gazetës “Veterani”, ku ka ushtruar funksione të rëndësishme si gazetar, redaktor dhe drejtues i shtypit. Ai është angazhuar në pasqyrimin, hulumtimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë, si edhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut...

FAQE 2

### 117-VJETORI/ KONGRESI I MANASTIRIT, DRITË E SHKRONJAVE QË NUK SHUHET

MEVLUD BUCI

FAQE 13

81 VJETORI I ÇLIRIMIT TË ATDHEUT/OBVLP VEPRIMTARI FESTIVE TË LARMISHME

### SHUAIP METHASANIT I JEPET TITULLI “NDERI I OBVLP”



FAQE 5

Shkolla e Viçishtit, 28 dhjetor 1944

FAQE 13

## HISTORIA

### BRIGADA E IV-S I DHA ATDHEUT 274 DËSHMORË

FAQE 12-3

## KUVENDI I 8-TË

### OKDA, PROMOVUESE E VLERAVE ATDHETARE DHE TË TRASHËGIMISË HISTORIKE KOMBËTARE

Prof.asoc.dr. Bernard ZOTAJ

FAQE 4

## PERSONAZH

### SAKIP CAMI: NGA CIKLI “NGJARJE TË VËRTETA”

FAQE 5

## DOSSIER

### DËSHMORI TAHIR LOSHA, I RIU QË LA GJURMË NË HISTORI...

Nga Nexhbedin Basha

FAQE 13

## AKTUALITET

### KARDIOLOGËT DHE ANA SHKENCORE E “KONFERENCËS SË VJESHTËS”

NGA DR. LEONIDHA PEPPU

FAQE 14

## PROMOVIMI

## FSHVLPLPPSH BOTON DHE PROMOVON VEPRËN STUDIMORE SHKENCORE TË POLITOLOGUT, DIPLOMATIT DHE PUBLICISTIT KOSOVAR BASHKIM HISARI

# “DEKODIMI I KRIMEVE”...

**Halil RAMA – Mjeshtër i Madh**

Vepra studimore shkencore “DEKODIMI I KRIMEVE” e politologut, diplomatit dhe publicistit të mirënjohur kosovar Bashkim Hisari është një përmbledhje e detajuar shkencore dhe morale që analizon marrëdhëniet shqiptaro-serbe në dritën e së vërtetës historike, duke hedhur dritë mbi krimet e kryera ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë. Si redaktor i kësaj vepre dhe moderator i promovimit të saj ditën e tretë të Panairit të 28-të (Tiranë 2025), e pata më të lehtë pas rencesave kompetitive e profesionale të dy recenzentëve të saj: akademik Jusuf Bajraktari dhe Prof. Asc. dr. Shkelqim Xeka, të cilët edhe në këtë takim promovues mbresëlënës të organizuar nga Federata Shqiptare e Veteranëve të Luftërave për liri e pavarësisë të popullit shqiptar dhe Shtëpia botuese prestigjioze “PENa” e Prizrenit, bënë vlerësimet e tyre maksimale. Që në nisje të promovimit me pjesëmarrjen e dhjetra personaliteteve akademike, shkencore e të letrave, vura në dukje se veçoria e kësaj vepre, qëndron në faktin se ajo shkon përtej përshkrimit kronologjik të ngjarjeve, dhe i nënshtrohet analizës së natyrës së planifikuar dhe të organizuar të dhunës, e cila, sipas standardeve të së drejtës ndërkombëtare, përmbush kriteret e gjenocidit të përcaktuara në Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit (1948).

### KËNDVËSHTRIMI ANALITIK I AKADEMIKËVE

Vepra “Dekodimi i krimeve” është një përmbledhje e detajuar shkencore dhe morale për të analizuar marrëdhëniet shqiptaro-serbe, në dritën e së vërtetës historike, duke hedhur dritë mbi krimet e kryera ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë. Objektivi i saj është të kontribuojë në ndërtimin e një narrative, që ofron referencë të saktë, të besueshme dhe i reziston manipulimeve, mohimeve dhe keqinterpretimeve, që ende janë të pranishme në diskursin politik e akademik serb.

Parë nga ky këndvështrim, akademiku i mirënjohur kosovar, Prof. Dr. Jusuf Bajraktari, ndër të tjera vlerëson se libri i Z.Hisari është një studim serioz publicistik-shkencor, i cili është punuar me barometrat e metodologjisë së punës shkencore. Kjo për faktin se “vlerësimet e tij kanë një peshë të veçantë, sepse ai përveç përgatitjes teorike që e ka, konkluzionet e tij i nxjerr në mbështetje të praktikës dhe përvojës si kuadër i terrenit në të dyja fushat, të cilat e kondicionojnë njëra tjetrën. Në këtë kontekst ai i trajton ngjarjet dhe proceset nga aspekti i një analisti të ngjarjeve socio-politike, duke qenë i pajisur edhe me njohuritë e grumbullimit të fakteve nëpërmjet emisioneve televizive ndërkombëtare, me ç’rast ai i ka vizituar zonat më të dëmtuara nga çmenduria e ofensivave më të përgjakshme të sol-



dateskës shoviniste millosheviqiane”.

Të gjitha këto autori i ka parë me sytë e vetë si dëshmitar okular dhe si të tilla i ka regjistruar edhe në shiritin filmik, e që për fat janë emituar nga qendra të ndryshme televizive botërore. Këto dëshmi tronditëse, Hisari jo vetëm që i disponon, por ia prezanton lexuesit në këtë botim shumë të veçantë për nga gama e vështrimit dhe për nga nevoja imediate me të cilën sot Kosova ka për ta bërë të njohur të vërtetën e saj të hidhur.. Ndërsa recenzenti tjetër, Prof. asc. dr. Shkelqim Xeka, ndër të tjera eidenton faktin se vepra ‘DEKODIMI I KRIMEVE’ e politologut, diplomatit dhe publicistit Bashkim Hisari, pasqyron realitetin historik të marrëdhënies shqiptaro-serbe të cilat përbëjnë një ndër kapitujt më të ndërlikuar të historisë së Ballkanit. Kjo sipas tij për faktin se duke qenë njohës i thellë i historisë dhe i marrëdhënies ndërkombëtare, veçanërisht atyre shqiptaro-serbe, dhe duke u mbështetur në përvojën e fituar gjatë punës shumëvjeçare në fushën e mediave, të drejtave të njeriut, posaçërisht në hulumtimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës, Bashkim Hisari në këtë vepër ka

Nga ky këndvështrim e vlerëson këtë libër edhe Znj.TatjanaParllaku Çarkaxhiu-kryetare e OBVLP, poetja dhe prozatorja e njohur Bujana Malaj, Drejtori i Shtëpisë Botuese “Pena” Mensur Bytyqi, Prof. asc. dr. Keida Ushtelena dhe nënkryetari i OBVLP kolonel Trifon Llup.

### FAKTE RRËQETHËSE E TEJET TRISHTUESE TË GENOCIDIT TË PASHEMBULLT SERB NË KOSOVË

Vetë autori Hisari, në promovimin e veprës së tij studimore shkencore solli fakte rrëqethëse e tejet trishtuese të gjenocidit të pashembullt serb ndaj popullsisë së pafajshme kosovare.

Gjatë luftës 1998-1999 të zhvilluar të në Kosovë,

forcat serbe kanë vvarë 13.535 persona, përfshirë 1.688 fëmijë. Janë zhdukur 1.640 banorë, ndërsa 20.499 gra e vajza shqiptare janë dhunuar dhe rreth një milion shqiptarë janë dëbuar me dhunë nga trojet e tyre. Po ashtu, janë shkatërruar ose dëmtuar 100.589 shtëpi të popullsisë shqiptare, 358 shkolla, 30 shtëpi kulture, 93 biblioteka publike, si dhe 123 objekte shëndetësore, fetare dhe pasuri kulturore, ndër të tjera. Pikërisht, nisur nga ky bilanc tragjik i gjenocidit serb në Kosovë, kjo vepër është një thirrje për reflektim për drejtësi, duke nxjerr në pah pasojat tragjike të historisë dhe nevojën për t’i parandaluar ato që të mos përsëriten kurrë. Në fakt në libër, nëpërmjet analizës së dokumentuar të fakteve historike, pasqyrohen ndryshimet historike përgjatë periudhave të ndryshme të zhvillimeve politike e shoqërore, që kanë shënuar marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Kësaj, “Dekodimi i krimeve” është një përmbledhje e detajuar shkencore dhe morale që analizon marrëdhëniet shqiptaro-serbe, në dritën e së vërtetës historike, duke hedhur dritë mbi krimet e kryera ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë. Objektivi i saj është të kontribuojë në ndërtimin e një narrative, që ofron referencë të saktë, të besueshme dhe i reziston manipulimeve, mohimeve dhe keqinterpretimeve, që ende janë të pranishme në diskursin politik e akademik serb. Kësaj marrëdhënies shqiptaro-serbe përbënë një ndër kapitujt më komplekse dhe më të tensionuara të histories së Ballkanit. Ato janë karakterizuar historikisht nga konflikte të thella politike, etnike dhe territoriale, të cilat kanë lënë pasojë të mëdha në zhvillimin e dy popujve (shqiptarëve dhe serbëve). Këto tensione u thelluan ndjeshëm, veçmas gjatë luftës së fundit në Kosovë.

### STRUKTURA E LIBRIT DHE PAK NGA CV E AUTORIT

Vepra studimore-shkencore me 348 faqe “Dekodimi i krimeve” është kompozuar në pesë kapituj: Konteksti historik i marrëdhënies shqiptaro-serbe; Udhët e vështira dhe të dhimbshme pas Luftës së Dytë Botërore; Ngjarjet që paraprinë intervenimin e NATO-s; Lufta e Kosovës-nga masakrat te aktet e gjenocidit serb kundër civilëve shqiptarë dhe Kosova në fokusin e politikës ndërkombëtare pas intervenimit të NATO-s. Në këtë vepër komplekse shumëpërmasore argumentohen shkencërisht marrëdhëniet shqiptaro-serbe të karakterizuar historikisht nga konflikte të thella politike, etnike dhe territoriale, të cilat kanë lënë pasojë të mëdha në zhvillimin e dy popujve (shqiptarëve dhe serbëve). Këto tensione, shkruan autori Hisari, u thelluan ndjeshëm, veçmas gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Bashkim Hisari ka një karrierë të gjatë dhe të shumanshme në fushën e gazetarisë, diplomacisë dhe të drejtave të njeriut. Nga viti 1998 është angazhuar në hulumtimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë, në kuadër të organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Më parë ai ka shkruar dhe botuar librin “HISTORI TRAGJIKE NGA LUFTA SHQIPTARO-SERBE” si dhe shumë studime dhe shkrime publicistike, të botuara në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja.

Ka qenë pjesë e Shërbimit Diplomatik të ish-Jugosllavisë, në detyra Konsull në Konsullatën e Përgjithshme në Hamburg dhe Shtutgart-RF e Gjermanisë dhe Sekretar i Parë i Ambasadës në Bern-Zvicër.

Është anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (IFJ), ndërkohë ka qenë shef i Zyrës së Këshillit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Prishtinë...

## FJALA

### Dokumentimi dhe pasqyrimi real i krimeve të luftës në Kosovë



### TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU

Është kënaqësi e veçantë për ne, Organizatat e Bashkuara të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, që së bashku me Organizatën e Veteranëve të Luftës të Kosovës, të bashkuar në Federatën Shqiptare të Luftëtarëve për Liri e Pavarësi, të përurorjmë sot në Tiranë librin “Dekodimi i Krimeve” të studiuesit, diplomatit, redaktorit dhe gazetarit të shquar, z. Bashkim Hisari. Prej njëzet vitesh Bashkimi është

zëvendësredaktor i gazetës “Veterani”, ku ka ushtruar funksione të rëndësishme si gazetar, redaktor dhe drejtues i shtypit. Ai është angazhuar në pasqyrimin, hulumtimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës në Kosovë, si edhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Shquhet kontributi i Bashkimit në mbrojtjen dhe pasqyrimin e historisë së lavdishme të shqiptarëve ndër shekuj, të luftërave tona kombëtare për liri e pavarësi. Është meritë e dy organizatave të luftës së popullit shqiptar – kundër nazifashizmit dhe e luftëtarëve të UÇK-së deri në pavarësinë e Kosovës – që kjo histori përcillet me dinjitet, kundër bishës milosheviqiane.

Midis nesh nuk ka ndarje; ne i kemi paraprirë bashkimit kombëtar me bashkimin e dy organizatave tona dhe presim me besim bashkimin e plotë kombëtar të të gjitha trojeve tona.

Për këtë bashkim ka punuar edhe vetë Bashkimi, i cili me veprat e tij edukon brezat e rinj me dashurinë për atdheun, lirinë dhe drejtësinë; që të rinjtë të njohin historinë e lavdishme të kombit shqiptar, luftërat e tij për liri dhe pavarësi, si dhe sakrificat e atyre që në lulen e rinisë derdhën gjakun e tyre për ditët që gëzojmë sot. Ata na bëjnë të përkulemi me respekt para jetës dhe veprës së tyre. Duke e mbyllur, i urojmë Bashkimit shëndet dhe suksese të mëtejshme në kulmin e arritjeve të tij.

## EDITORIALI

# Paslufta është një histori tjetër

Nga Petro KOÇI

**L**ANÇ ishte një pozicionim i qartë politik dhe ushtarak i Shqipërisë në Luftën e II-të Botërore. Nëse teatrin luftarak vendor do ta kishte dominuar Balli dhe jo Fron-

ti atëhere Shqipëria do përfundonte si humbëse e luftës dhe pjesëtare e Koalicionit nazifashist.

A kishte edhe luftë për pushtet nga të dyja palët gjatë pushtimit?

Sigurisht. Por Fronti Antifashist zgjodhi rrugën e luftës, gjë që detyroi edhe gjermanët të dislokonin në Shqipëri forca ushtarake të konsiderueshme, ndërsa Balli zgjodhi rrugën e kolaboracionizmit, gjë që i çoi ata në fatin e tradhtisë.

Kjo lloj tradhëtie u ndëshkua me vdekje në të gjithë vendet antifashiste.

Por edhe përplasjet për pushtetin e ardhshëm nuk mund të konsiderohen luftë civile. Po të ishte kështu ballistët e sotëm duhet të marrin përsipër autorësinë e vrasjes së shumicës së dëshmorëve të luftës prej paraardhësve të tyre.

E vërteta është se vetëm një pjesë e tyre janë ekzekutuar nga Balli. Shumica janë vrarë në betejat me pushtuesit italianë dhe gjermanë.

A ka patur gabime dhe faje lufta? Sigurisht.

Por gabimet më të rënda bëhen në kohë paqeje mendoj unë. Dhe në fakt të gjithë ata që mallkojnë LANÇ - in më shumë i referohen pasluftës. Por paslufta është një histori tjetër.



**HISTORIA - Më 28 dhjetor 1943, me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm formohet një nga njësitë më të mëdha e të organizuara të luftës partizane**

## Brigada e IV-S i dha Atdheut 274 dëshmorë

Ing. Myfit GUXHOLLI\*

Ish-partizan i Brig. IV S

- **Brigada IV S i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet tyre N/komandant i Brigadës Pano Xhamballi, Xhafer Cenko Lubonja, komandanti trim Riza Taçi etj; të cilët prehen të qetë në altarin e lirisë së atdheut. Vetëm në luftën për çlirimin e Tiranës ranë në fushën e nderit 98 partizanë. Brigada IV S në 321 ditë të jetës së saj ka përshkruar 2200 km rrugë (në këmbë, jo me makina) duke kryer 265 luftime e operacione dhe duke i shkakuar armikut mbi 2000 të vrarë e 200 robër (shumë ushtarë gjermanë) si dhe dëme të mëdha materiale e armatime**

Me 28 dhjetor mbushen 82 vjet nga dita kur në Voskopojë u krijua Brigada e IV-t Sulmuese. Ajo ishte ndër njësitë më të organizuara të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila në 321 ditë të jetës së saj ka përshkruar 2200 km rrugë (në këmbë, jo me makina) duke kryer 265 luftime e operacione dhe duke i shkakuar armikut mbi 2000 të vrarë e 200 robër (shumë ushtarë gjermanë) si dhe dëme të mëdha materiale e armatime.

### HISTORIA

Në qarkun e Korçës deri në dhjetor 1942 ishin formuar 18 çeta partizane, midis të cilave ajo e Mokrës (Pogradec), e Gorë-Oparit etj. Ndërsa nga tetori '42 deri në maj 1943 numri i çetave partizane u rrit akoma. Më vonë, me rritjen e numrit të forcave të kryengritjes së armatosur nga çetat u krijuan batalionet partizane si Batalioni i Mokrës, Gorës, Kolonjës, Rrëzës, Malit të Thatë, Batalioni "Shqiponja" etj.

Si rezultat i luftimeve të ashpra të këtyre batalioneve me forcat armike u realizua çlirimi i zonës malore të Qarkut të Korçës.

Në gusht 1943 formohet njësi më e madhe luftarake e Ushtrisë Nacionalçlirimtare në Makrezë të Vithkuqit me partizane e partizanë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, me komandant Mehmet Shehun, komisar Tuk Jakovën dhe zv/komandant Tahir Kadarenë. Ndërsa, më 28 dhjetor 1943, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm formohet Brigada e IV-të Sulmuese. Në përbërje të saj ishin batalionet me përvojë luftarake, si "Hakmarrja", "Reshit Çollaku", "Shqiponja", "Fuat Babani", batalioni Gorë-Opar si dhe "Rinia antifashiste dhe punëtore" nga qyteti i Korçës. Në fillim Brigada kishte 550 partizanë e kuadro të organizuar në katër batalione: batalioni 1 me komandant Zija Kambo, i 2-të me komandant Petrit Dumen, i 3-të me komandant Spiro Moisiu e komisar Vaskë Gjiron, i 4-ti me komisar Andrea Ziu. Intendent i Brigadës ishte Raqi Qirinxhi. Brigada IV Sulmuese, një repart i armatosur, me 265 luftime dhe operacionet e saj u konfirmua si një njësi luftarake e aftë për të kryer detyra akoma më të mëdha. Ajo u rreshtua në Divizionin e I-rë Sulmues, të cilit iu ngarkua një detyrë e rëndë-

sishme, siç ishte kalimi në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut dhe çlirimi i tyre nga okupatori nazist e kolaboracionistët e tij. Faqe lavdie e trimërie tregoi Brigada e IV-të S në Operacionin armik të Dimrit 1943-1944. Ajo zhvilloi luftime të përgjakshme dhe shpërtheu rrethimin që nazistët gjermanë kishin përgatitur gjatë këtij operacioni. Luftime të kryen në kompaktësi bashkëveprimi mes batalioneve të brigadës. Në një kohë që forcat armike mendonin të shkatërronin forcat partizane të saj dhe forcat e Beratit, Brigada e IV-të S, e drejtuar nga shtabi i saj me në krye komandant Nexhip Vinçani e komisar Pëllumb Dishnica çau rrethimin në Qafën e Becit, duke kaluar në zonën e Beratit.

Mbas çarjes së rrethimit, brigada u kompaktësua dhe për një muaj rresht, me luftime sulmuese dhe në bashkëveprim me batalionet "Hakmarrja", "Shqiponja", "Reshit Çollaku", "Fuat Babani" e forcat sulmuese të fshatrave të qarkut çliroi shumë fshatra, duke filluar nga Arrëzi (Devoll), Malësia e Kolonjës, Vithkuqit, Gorë-Oparit, Shënepremte. Në pranverë, gjatë mësymjes pranverore, në bashkëpunim me batalionet "Reshit Çollaku" dhe dy batalione të Brigadës së I-rë S çliroi Pogradecin dhe Rrëzën e tij, Starovë, Tushemisht, Hudënisht, Piskupat, Grabovë. Mbas gjithë këtyre suksesëve, Brigada mblihet në Lozhan për të bërë bilancin e luftimeve në 9 maj 1944. Numri i partizanëve ishte shtuar. Gjatë muajit maj brigada çliroi fshatrat në fush-

ën e Korçës, Rrëzës, Gor-Opar duke përfshirë dhe zonën e Mokrës, Pogradecit, Malit të Thatë, Pojan etj. Gjatë Operacionit Armik të Qershorit 1944, batalionet e Brigadës IV S zhvilluan luftime të ashpra në Qafë Thanë me forcat e Divizionit malor gjerman. Luftime të ashpra u zhvilluan në Maliq, Grabovë, Plloçë, Guri i Kamjes, Kroshisht, Moçan, Osojë, Gjnikas, Malin e Dusharit, Qafa e Gjarperit, në Bitinckë e Bilisht.

### KALIMI NË MËSYMJEN E PËRGJITHSHME

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇL lëshoi Urdhrin, më 28 Maj 1944 për kalimin në Mësymjen e Përgjithshme. Brigada IV S, pasi kishte kaluar një rrugë të suksesshme luftarake dhe në çlirimin e një territori të madh në Qarkun e Korçës, u inkuadrua në Divizionin I Sulmues të UANÇL. Gjatë luftimeve në përbërje të këtij divizioni (brigada IV dhe V) çliroi Qarrishtën, Zerganin, Matin, Homesh-Sofraçan, Fushë Alie, Grejë, Melan, në kazermat e Dibrës, kundër forcave gjermane e kolaboracioniste në Mirditë; çliroi Peshkopinë etj. Në dy javët e fundit të shtatorit Brigada e IV-të S zhvilloi luftime brenda në Elbasan dhe organizoi disa prita në rrugën Librazhd-Elbasan-Qafë Kërrabë.

Nga krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut populli u bind për luftën e drejtë kundër okupatorit dhe veglave të tij; u rreshtuan në radhët e partizanëve deri 2000 veta. Midis tyre kishte dhe disa partizanë italianë dhe armenë, të cilët kishin hyrë në UANÇL mbas kapitullimit të Italisë në shtator 1943.


Brigada e IV S shkroi faqe faqe lavdie gjatë operacionit për çlirimin e Tiranës. Ajo, së bashku me Brigadën e I-rë S, Brigadën e VIII-të dhe Brigadën e XVII-të sulmoi në një rajon tepër të fortifikuar; duke filluar nga kodrat pranë Kombinatit Tekstil në veriperëndim të Tiranës, deri tek kodra e Kopilit (sot sanatoriumi- varret e dëshmorëve të kombit).

Po ashtu mori pjesë në luftime të varrezat e dëshmorëve të kombit, në Pallatin e Brigadave, tek ish Kisha e Shën Prokopit (në veri të Liqenit Artificial, ish-kazermat e Shkumbinit (qyteti i nxënësve, brenda në qytet tek pallatet e Moskatit dhe të Shallvares dhe deri tek Banka).

Brigada IV S, në betejën historike të Mushqetas (duke filluar nga Qafë Kërraba-Mushqeta) luajti një rol të rëndësishëm në shpartallimin dhe asgjësimin e forcave të mëdha gjermane. Brigada e IV-të S në operacionet për çlirimin e Tiranës tregoi vlerat e saj si njësi luftarake e suksesshme dhe e denjë për emrin që mbante, duke përmbushur me nder detyrat e ngarkuara. Aftësitë e kuadrove, partizanëve e partizaneve spikatën si çlirimtarë të suksesshëm. Rruga luftarake e Brigadës IV S, trimëria, heroizmi i luftëtarëve të saj në luftë për çlirimin e vendit, janë sot një burim i madh frymëzimi për popullin dhe veçanërisht për brezin e ri.

Brigada IV S i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet tyre N/komandant i Brigadës Pano Xhamballi, Xhafer Cenko Lubonja, komandanti trim Riza Taçi etj; të cilët prehen të qetë në altarin e lirisë së atdheut. Vetëm në luftën për çlirimin e Tiranës ranë në fushën e nderit 98 partizanë.

\*Ish nënkryetar dhe kryetar i OBVL



## KUVENDI I 8-TË

# OKDA, promovuese e vlerave atdhetare dhe të trashëgimisë historike kombëtare

**Prof.asoc.dr. Bernard ZOTAJ**  
**Mjeshtër i Madh**

**D**itë më parë Organizata Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ-it dhe Dëshmorët e Tjerë të Atdheut zhvilloi Kuvendin e VIII të saj. Në këtë Kuvend Organizata analizoi punën e saj që si një institucion kombëtar ka promovuar ruajtjen e kujtesës historike të dëshmorëve që kanë sakrifikuar jetën për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, si dhe në mbrojtje të interesave të familjeve të tyre.

Organizata me një përkushtim të veçantë ndaj vlerave kombëtare, ka zhvilluar veprimtari kulturore, edukative dhe sociale në përkujtim të dëshmorëve, të një cilësie të mirë dhe të një bashkëpunimi të frytshëm me të gjithë anëtarët e organizatës, të institucioneve, të shkollave dhe të pushtetit lokal.

Organizata u krijua në vitin 1995, në një kohë kur nevoja për ruajtjen e kujtesës dhe të historisë së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) dhe kontributit të dëshmorëve ishte një domosdoshër e kohës. Që nga themelimi i saj, Organizata ka qenë një zë i fuqishëm për nderimin dhe



respektimin e dëshmorëve dhe ka kontribuar në ruajtjen e monumenteve historike, organizimin e aktiviteteve përkujtimore dhe publikimin e materialeve historike për 61 bashkitë e vendit.

Në realizim të misionit të Organizatës, për ruajtjen dhe promovimin e kujtesës historike për dëshmorët e Atdheut, është punuar për të mbajtur gjallë edukimin atdhetar tek anëtarët, simpatizantë dhe brezi i ri të rëndësisë, të sakrificës dhe të dashurisë të dëshmorëve për atdheun. Në këto vite organizata ka demonstruar se ka qenë udhëheqëse në promovimin e vlerave atdhetare dhe në ruajtjen e figurës së dëshmorit të atdheut dhe të trashëgimisë historike kombëtare.

Organizata ka organizuar një sërë aktiviteteve të rëndësishme: Kulmore ka qenë festimi i 80 vjetorit të çlirimit të Atdheut me përkujtimoren në Tiranë "Shqipëria e Dëshmorëve", në nëntor 2024, me të gjitha familjet e dëshmorëve të Atdheut. Kryesia dhe degët në të gjitha bashkitë e vendit organizuan gjatë gjithë vitit të 80 vjetorit të çlirimit të Atdheut, përkujtimore në ditët e rënies së dëshmorëve dhe heronjve, duke organizuar sesione shkencore dhe akademi përkujtimore, montazhe artistike, biseda e takime me nxënës të shkollave 9 vjeçare dhe të gjimnazëve, hapje të ekspozitave, ngritje të këndeve të dëshmorëve në shkolla e kudo, etj.

## ORGANIZATA PËRCAKTOI DHE DETYRAT THEMELORË PËR PERIUdhËN NË VIJIM

- Bashkëpunim me organet publike si domosdoshmëri suksesi dhe nevojë e kohës.
  - Rëndësi të madhe vlerësimit të figurës së dëshmorit dhe të Familjeve të Dëshmorëve.
  - Botimit të librave, të shkrimeve dhe të dokumentarëve që përshkruajnë jetën dhe veprën e dëshmorëve, dhe pasqyrim në rrjetet masive të kohës.
  - Vëmëndje restaurimit të monumenteve të dëshmorëve.
  - Bashkëpunim me shkollat për edukimin e të rinjve mbi historinë kombëtare.
  - Organizimit të konferencave, sesioneve shkencore dhe ekspozitave përkujtimore për figurën e Dëshmorit të Atdheut.
  - Rëndësi të vijueshme për organizatën është ruajtja e statutit dhe e strukturës organizative
- Kuvendi zgjodhi organet drejtuese të Organizatës, Këshillin Kombëtar, Kryesinë, Këshilli i të urtëve dhe të diturve, Komisionin e Kontroll-Revizionit, si dhe Kryetar dr. Gjergji\_Velo, zvendëskryetar Shaqir Vukaj, Spartak Braho, Kujtim Haxhia dhe Bernard Zotaj, Redaktorin Përgjegjës të Revistës "Pavdekësia" Zenel Gajpaj.

## GJAKOVË - U SHËNUA DITA E ÇLIRIMIT DHE E FORMIMIT TË BRIGADËS SË SHTATË SULMUESE

*Në mënyrë solemne në Gjakovë, u shënuar Dita e Çlirimit nga okupatori nazi-fashist dhe dita e formimit të Brigadës së Shtatë Sulmuese.*

**M**e këtë rast u mbajt mbledhja e zgjeruar e Kryesisë së Degës së Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OVLANÇ), ku morën pjesë pasardhësit e veteranëve të LANÇ, anëtarë të Kryesisë së Veteranëve të LANÇ-it të Kosovës, përfaqësues të veteranëve nga Malësia e Gjakovës, si dhe përfaqësues të Federatës Shqiptare të Luftërave për Liri dhe Pavarësi.

Në shenjë nderimi, pjesëmarrësit vendosën lule dhe kurora në varrin e Heroit të Popullit Fadil Hoxha, në varrin e ish-kryetares së OVLANÇ-it të Kosovës, Vahide Hoxha, si dhe në varrezat e dëshmorëve të UÇK-së.

Duke folur për rëndësinë e këtyre datave historike, kryetari i veteranëve të LANÇ të Gjakovës, Gazmend Hoxha, ndër të tjera tha:

"Përkujtimi i ngjarjeve të rëndësishme si kjo e sotmja, nuk është vetëm një rikthim në të kaluarën tonë historike, por para së gjithash, është një moment reflektimi dhe shprehje e respektit e mirënjohjes për përpjekjet dhe sakrificat e mëdha të popullit tonë. Populli ynë, me luftën e tij çlirimtare, u rreshtua në anën e Koalicionit Antifashist dhe bëri zgjedhjen e duhur – u bë pjesë e fitimtarëve të Luftës së Dytë Botërore."

Ai theksoi se Dita e Çlirimit të Gjakovës dhe rrethinës nga okupatori nazi-fashist është një datë e veçantë historike, që nuk mund të harrohet:

"Çlirimi i Gjakovës na kujton luftën heroike të popullit shqiptar të kësaj ane dhe të Kosovës në përgjithësi. Ishte një luftë e drejtë për çlirim kombëtar e shoqëror, për të jetuar në një shtet të lirë shqiptar – një ëndërr e kahmotshme e patriotëve tanë. Edhe pse sot Kosova është shtet i pavarur dhe demokratik, aspirata për bashkim shpirtëror e kombëtar mbetet një ideal i gjallë."


Në vazhdim të fjalës së tij, Hoxha shtoi se kombi



shqiptar ka mbijetuar ndër shekuj duke ruajtur vlerat, kulturën dhe virtytet e veta, dhe se "kurdoherë që e ka kërkuar koha, ka derdhur gjak për lirinë dhe tokën amtare.

## PERKUJTIMI

81 VJETORI I ÇLIRIMIT TË ATDHEUT/OBVLP VEPRIMTARI FESTIVE TË LARMISHME

SHUAIP METHASANI I JEPET  
TITULLI “NDERI I OBVLP”

**I**dhulli im, veterani 90-vjeçar SHUAIP METHASANI (me mendje e memorie për t'u patur zili, mishërues dhe përçues dinjitoz i urtësisë dhe mençurisë di-brane), me Kryetaren e OBVLP TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU, vendosën kurorën pranë monumentit të ushtarit të panjohur, ditën e 81 vjetorit të çlirimit të Tiranës nga pushtuesit nazifashistë, në nderim dhe përkujtim të heronjve dhe dëshmorëve të asaj lufte, si një nga epopetë më të lavdishme të LANÇ. Pas ceremonisë solemne, ku mbajti një fjalë rasti mbresëlënëse kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë, Z.Aldrin Dalipi, po aq mbresëlënësishte edhe bashkëbisedimi i ngrohtë

e miqësor me veteranin më të vjetër të OBVLP Riza Lika (ish-i burgosur politik, nga Baldushku i Tiranës), nënkryetarin e kësaj organizate kol. TRIFON LLUPO, Z.ILIRJAN ÇARKAXHIU dhe ish-ushtarakun shembullor Hysni Çela. Së bashku, ndërsa përkujtuam me nderim të veçantë gjeneral Dali Ndreun-strategun dhe drejtuesin kryesor të luftës legjendare për çlirimin e Tiranës dhe gjeneralin legjendar

Rrahman Parllaku, Hero i Popullit dhe Nderi i kombit, biseda kaloi te libri, ku unë pata kënaqësinë t'i dhuroja “poliglottit” Hysni Çela librin tim “MUHURRI, HISTORI DHE PERSONALITETE “ OBVLP zhvilloi veprimtari përkujtimore dhe vendosi kurura me lule pranë përmendores së Ismail Qemlit dhe monumentit “Nënë Shqipëri”, më 28 dhe 29 nëntor.

Në këtë kuadër si dhe me rastin e 90-vjetorit të ditëlindjes SHUAIP METHASANI u vlerësua me titullin “NDERI I OBVLP” me motivacionin: “Për evidentimin dhe promovimin e vlerave të LANÇ; mishërues dhe përçues i urtësisë dhe mençurisë di-brane në metropolin shqiptar”

H. RAMA

## PORTRET

## VEFI... MISIONARIA

- *Gjinovefa Kadriu, e cila është ndër më të “raskapiturat” në rrugëtimin e pandalshëm në mbrojtje të vlerave dhe simboleve të Luftës ANÇ, në veçanti në Tiranë, sot mban edhe detyrën e Kryetares të OKDA, dega e Kryeqytetit*

## Nga Bashkim Koçi

**N**jerëzit patriotë e të sakrifikuar për fatet e vëndit janë si shenjtët. Është bekim për pasardhësit dhe mënyra më e mirë e nderimit për ta, nëse imitojmë rrugëtimin e tyre ashtu siç nuk janë të paktë ata në trojet tona që, në të gjithë veprimtarinë e tyre, na shfaqen ashtu si gjyshërit e etrit në luftërat që kanë bërë për liri e pavarësi.

Në çka po them kam parasysh një njeri konkret, një njeri i cili me shpirt e zëmër është e lidhur me historinë tonë të së shkuarës e që, e gjitha, fillim e mbarim, është dhe mbetet pjesë e njerëzve të gjakut të saj. E kjo është Gjinovefa Kadriu, një shoqe që nuk ja gjen shoqen në çka ajo ka bërë e bën për të nderuar dy shenjtët, veteranët e LANÇ dhe gjakun e Dëshmorëve të Atdheut. Di që ecuria e veprimeve fillon në familje e madje është familja, vatra atërore ajo ku lind dhe kalitet virtyti. Gjinovefa Kadriu, e cila është ndër më të “raskapiturat” në rrugëtimin e pandalshëm në mbrojtje të vlerave dhe simboleve të Luftës ANÇ, në veçanti në Tiranë, sot mban edhe detyrën e Kryetares të OKDA, dega e Kryeqytetit.

Të veprosht është të krijosh, dhe të krijosh është e vetmja kënaqësi reale dhe efektive që njeriu mund të shijojë në këtë botë. Vefit (Ginovefës) kënaqësinë për të mbetur “rrugëve”, janë veteranët, ish partizanët e paktë që janë ende gjallë, ku ngjarjet dhe historitë e tyre të Luftës i sjellin si të lexojë një libër ku si-

kur njihet e përjeton atë çka bëri gjyshi i saj Kostë Lala, një ndër burrat që ndihmuan Ismail Qemalin në udhëtimin historik për të kaluar lumin e Vjosës, e që më 28 Nëntor të vitit 1912 të ngrinte Flamurin e Pavarësisë në Vlorë. Vefi këtë ngjarje e mban gjallë me punën që bën, duke e konsideruar edhe si një simbol krenarie për brezat e së shkuarës dhe këta të sotmit.

Një njeri i vendosur nuk ka kurrë një mendim të dyshimtë. Kjo edhe për faktin se kujtimet nuk vdesin, ata trashëgohen. Dhe kjo çka them e gjen të shkruar në historinë familjare të këtij fisi me emër në tërë Labërinë. Janë histori të vërteta lufte, e jo fantazira romanesh. Dy xhaxhallarët e saj, Lllazar e Filip Lala, u bënë pjesë e formacioneve partizane në Luftën ANÇ dhe luftuan deri në çastin kur u njoftua shporrja e pushtuesit nga trojet e pushtuara. Vefi i ka në gjak nderimin për të parët e saj dhe nuk është ndalur për të mbetur veprimtare me zëmër nga moshë e herëshme e rinisë e deri më sot. Dhe e farkëtuar në mjedise ku historia tregohet dhe ilustron me fakte, Vefi ka mësuar një gjë që e mban si të jetë busull orjentues për ta përcjellë tek brezi i ri. Sepse të mos dish se çfarë ka ndodhur më parë me historinë e vëndit tënd, të qytetit tënd apo edhe me rrënjët e familjes tënde, është si të mbetesh gjithmonë fëmijë.

Historia e luftimeve, siç është edhe Lufta ANÇ, janë histori dhimbjesh. Janë të tilla sepse ato mbajnë brenda vetes histori jetësh të vrara, janë bij dhe bija që iu pre jeta në mes kur ende nuk e kishin filluar



jetën. Gjinovefa Kadriu, duke qenë në krye të Degës së OKDA të Tiranës, i duhet të jetë brenda jetës së dëshmorëve, të njohë dhe të eksplorojë ëndërrat e tyre kur ata ishin të rinj, për t'ua treguar si në një film të “xhiruar” prej vërteti. Vefi di si “të sillet” me dëshmorët, di si t'i trajtojë një e nga një e jo në lista evidencash. Ajo në të gjithë këtë punë, të cilën e përballon në grup me shumë dashuri, ka parasysh se respekti ndaj të rënëve vlen më shumë se emri i mirë, konsiderat ndaj tyre më shumë se fama dhe nderi që meritojnë është baraz me lavdinë e tyre. Gjinovefa Kadriu ka aftësinë që misionin dhe passionin për të vlerësuar Luftën ANÇ dhe Dëshmorët e Lirisë ta ketë motivin e saj për t'i paraprirë dëshirës së zjarrtë, e cila është ndër më të mëdhatë në veprimtaritë njerëzore.

## ANALIZA

Dy librat e gjeneral Qazimit, një qasje e re dhe një mendim profesionist në tregun e librave të sigurisë

# PËLLUMB QAZIMI GJENERALI DHE DIPLOMATI PËR LUFTËN DHE SHQIPTARËT

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Për librat e rinj dhe jo vetëm, latinët kanë lënë një shprehje të pakontestueshme nëpër shekuj se, "Habent sua fata libelli/ Librat kanë fatin e tyre". Kështu edhe dy librat e gjeneral Pëllumb Qazimit janë një qasje e re dhe një mendim profesionist në tregun e librave të sigurisë dhe mbrojtjes. Pas librit të tij të parë "Histori e ushtrisë shqiptare: 1912-1991", që realisht ishte një sukses i plotë pasi ka pasur një konsulentë të gjerë shkencore si dhe një "usta" të kalibrit ndër-kombëtar, sikurse ishte mentori dhe udhëheqësi shkencor, një kolos i mendimit albanolog Aleksandar Stipčević ilirolog, historian, arkeolog dhe studiues arbëresho-kroat. Autori i librit i ngjiti shkallët e karrierës ushtarake në mënyrë të "ngeshme", me besim dhe vendosmëri. Pëllumb Qazimi nuk e zgjodhën, por e përzgjedhën për të drejtuar nivelet më të larta të lidershipit ushtarak, për aftësi dhe erudicion, intelektual ushtarak profesionist, që u rrit dhe formua me bazë "zbulues" në akademitë më të mira ushtarake të vendit, por edhe në shkollat dhe akademitë e perëndimit si dhe ato diplomatike. Ky formim dhe vështrim i raliteteve e shtroi dhe e përqasi aty ku e ka vendin në fakt në anën e studjuesve të historisë ushtarake, të doktrinave dhe strategjive, të luftës dhe të vështrimit mbi historinë e shqiptarëve. Ambasador Ditmir Buashti ish-Ministër i Punëve të Jashtme, në parathënien e librit më të fundit të Dr. Gjeneral dhe Ambasador Pëllumb Qazimit, "Lufta dhe Shqiptarët", e klasifikon si kontribues dhe personalitet më të shquara të fushës së sigurisë dhe diplomacisë, që ka sjellë për lexuesin, "analizë në mënyrë shteruese të raportit të luftës me ne, shqiptarët, duke i qëndruar fort argumentit se kombi shqiptar asnjëherë nuk ka qenë komb agresor, por nga ana tjetër, vendi ynë ka qenë arenë lufte apo fushëbeteje për palë të tjera ndërluftuese".

## "LUFTA DHE SHQIPTARËT" JO NJË LIBËR PËR STOLI BIBLIOTEKASH

Pak ditë më parë nga shtëpia botuese "M&B" ka publikuar librin më të ri të gjeneral Pëllumb Qazimit, që vjen në këtë libër pas shumë viteve të vrullshme dhe më të pjekura në fushën e mendimit ushtarak, por dhe diplomatik që nuk mund të shikohen të shkëputura nga mendimi dhe shkencat e tjera të studimit.

Fati i këtij libri është i parashkrur sepse aparati konceptual i librit, ka sjellë atë me çfarë janë "ushqyer" shekujve, por jo vetëm shqiptarët por mbarë planeti ynë u ka folur shekujve më shumë për histori luftarash se sa paqe apo për histori ekonomike. Lufta kjo shkencë dhe art i shkatërrimit të njerëzimit ka prekur sipas analistëve e historianëve në rreth 5500 vitet e fundit, vetëm 300 vite kanë qenë paqe. Pjesa tjetër është vetëm Luftë, dhe kjo ka qenë shqetësimi dhe motivi për të shkruar pikërisht këtë libër për luftën, këtë fantazmë shfarrosëse që shqiptarëve u ka mbirë në prag nga lindja dhe nga perëndimi. Autori Qazimi vjen në këtë libër, me një ndjenjë sigurie për të thënë fjalën e vet për të shkruar shqiptarëve në dymbëdhjetë krerë. Më konkretisht përmes mendimeve të konceptuara flet për: "Lufta", "Shqipëria në paleoluftën", "Tre zhvillime të luftës së ftohtë", "Arsye të mosdukjes së Shqipërisë", "Kombi shqiptar, jo komb agresor", "Paleolufta dhe neolufta, të përbashkëta dhe dallime", "Domosdoshmëria e Forcave të Armatosura", "Zhgënjimi ndaj ushtrisë", "Diplomacia dhe roli i saj", "Transformimi ushtarak, proces i vijueshëm", ku përveç krerëve të plotë në 318 faqe, libri përmban edhe aparat shkencor të pasur 194 libra e litaraturë ku dominon literatura në gjuhë të huaj. Libri përmban hyrje, parathënie të një diplomati të spikatur shqiptar të shkruara nga këndvështrimi i një diplomati karriere, një hyrje të sinqertë të kohës që jetoi në kohën e paqes së kërcënuar duke sjellë definicione rreth "paleoluftës, luftës së ftohtë dhe neoluftës", si dhe mjaft material të pasur që meritojnë vëmendjen e studjuesve dhe sidomos historianëve ushtarakë.

## DEPËRTIMI NË MISTERET E HISTORISË SË LUFTAVE TË SHQIPTARËVE

Gjeneral Pëllumb Qazimi si njohës edhe i figurave të albanologjisë dhe gjuhëtarisë dhe ja vlen të sjellim një shprehje të Eqrem Çabej, kur flitet për luftrat / "grindjet": "Shqipëria është trualli në të cilin grindja e gjatë ndërjet botës romane-perëndimore dhe ballkanike-bizantine, është shprehur në mënyrën më të spikatur... ky qëndrim i ndërmjetmë



midis Perëndimit e Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë fytyrën e saj të veçantë, që nuk mundi ta fshijë as sundimi romak, as bizantin dhe as osman... Shqipëria ka qenë e orientuar më tepër nga Perëndimi sesa nga fqinjët e saj".

Kjo përputhet me konkluzionet e autorit dhe këndshikimin e tij për luftën dhe iliro-arbërorë-shqiptarët. Nga ana tjetër kjo përkon edhe me atë që thotë poeti i madh i rilindjes sonë kombëtare Naim Frashëri se: "Zhvillimi i Shqipërisë i përket modeleve socialkulturore perëndimore". Objekti i studimit të gjeneral Qazimit lidhet, me mbijetesën shqiptare gjatë shekujve, edhe përballë furive të makinerive luftarake nga më të rëndat e pushtimeve, u kanë mbijetuar planeve djallëzore, platformave Naçertanice dhe Megaliidea, mbijetesën përballë Traktatit të Shën Stefanit, Berlinit, Londrës, Parisit etj. Ndërkohë që për luftrat e shqiptarëve vlen të citohen fjalët e arta të Çabej, "si në kohën antike, edhe më vonë, ky popull malësor i fortë jep gjakun e tij për mbrojtjen e kombeve të reja ballkanike, jo vetëm me anë të përzjerjes etnike, por edhe në pikëpamje politike, si kasta luftëtare me armë në dorë", por edhe më tej ka qenë kasta luftëtare e mbarë Evropës me stradiotët e shquar shqiptarë.

Analiza e luftimeve për shqiptarët e sjellë nga Pëllumb Qazimi është për miqtë, për "vëllezërit e gjakut", për kundërshtarët e shekujve, për diplomacinë shqiptare të mbi një shekulli, për sakrificat e panumërta në lufta dhe në paqe, për orkeset e shtuara e deri tek "vrasjet e orkestruara të shqiptarëve", sikurse ishte ekzekutimi i mbi 3500 shqiptarëve në Masakrën e Tivarit që meriton rishqyrtim dhe analizë serioze bazuar në dokumente. Në këtë drejtim vëmendje merr veprimtaria antiandante më 1913-194, por dhe viti 1940, edhe lufta e parë dhe e dytë botërore, viti i sulmeve monarko fashistëve fqinjë jugorë më 1949, ligji i luftës, lufta 9 vjeçare e dibranëve, lufta e Koplikut, por dhe mjaft incidente mbi trupin e Shqipërisë në periudha komplekse historike. Gjeneral Qazimi përmes studimit ka njohur miqtë dhe armiqtë në Ballkan dhe jo vetëm, në pikëpamje të kapaciteteve të makinerive të tyre luftarake, por dhe nga aspekti i formatit politik, ekonomik, social, diplomatik, gjeopolitik etj. Autori na jep një panoramë të gjerë e të larmishme mbi momentet kyç ku e kaluara, rrugëtimi historik i ngritjes së shtetit, por dhe për periudhat epokale të shkatërrimit, kur kombi shqiptar nuk ka qenë kurrë një komb agresor, ndërkohë që lidhshmëria me traditën, të drejtën zakonore, kodifikimet dhe përmbajtja e tyre, kur flitet për "rregullat e jetës dhe të vdekjes", për të dhënë konsideracione të shumta mbi të djeshmen shqiptare. Ai ka sjellë të skalitur në muret e kujtesës sonë historike një prurje të re me vlerë që i shërben jo vetëm frymës patriotike, intelektualizmit por mbarë shqiptarizmit.

**SHIFRA DHE FAKTE NGA HISTORIA SHQIPTARE. "PA TË SHKUAR NUK KA TË ARDHME"**

- Promovimet e librave janë promovime vlerash, pasi filozofi i madh i botës Sokrati thoshte: "Ka vetëm një të mirë në jetë dhe ajo është "Dituria". Dituria e një jete njerëzore e depozituar në trurin intelektual, në "arkivin lëvizës", natyrshëm shkruhet, tregohet e publikohet, për një jetë intensive dhe të dinjitetshme. Ushtaraku madhor, ambasadori, intelektual Pëllumb Qazimi po jep një shembull të mirë duke e shkruar dy vëllimet e para: "Histori e ushtrisë shqiptare: 1912-1991" dhe libri më të ri "Lufta dhe shqiptarët". Gjeneralletënant dhe Ambasador Pëllumb Xhafer Qazimi, është vlerësuar me dhjetra dekorata dhe urdhëra ushtarakë, me titullin "Qytetar Nderi i Skraparit", por dhe nga SHBA me Medaljen "Legjioni i Meritës".

Të flasësh për shifra e fakte duhet të depërtosh thellë në arkiva, të njohësh të djeshmen e kombit dhe të hedhësh vështrimin edhe në të ardhmen e tij. Në libër gjenden me shumicë "shifra e fakte", që meritojnë edhe studjues të tjerë që të pasurojnë historinë tonë edhe me të dhëna të tjera më të bollshme arkivore, ndërkohë që tashmë rrugët e arkivistikës brenda dhe jashtë janë bërë edhe më të lira. Ato janë në fakt edhe më të hapura. Më vështirë në këtë fushë është të punosh me arkivat e fqinjëve veriorë dhe jugorë ndërkohë që për arkivat e tjera në botë flitet gjerësisht dhe rrugët në fakt janë "autostratë". Prandaj edhe maksima proverbiale spanjolle thotë se "...rrugët janë bërë duke ecur".

Autori Qazimi ndalet në librin e tij edhe tek aleancat, dje dhe sot, tek luftrat hibride, tek armiq të njohur dhe të panjohur, tek teknologjia e re e luftës, tek aktorët e faktorët, tek kompleksiteti, sjell raste nga përtej rajonit, nga konflikte dhe ligji i konfliktit të armatosur, nga Bosnja dhe Kosova, nga teatret e luftës, paqeruajtësit e paqebërësit. Gjeneral Qazimi sjell fakte reale por dhe definicione nga kolosë të mendimit sikurse janë Makiaveli, Karl Fon Klauzevici, Kolin Pauell, Samuel Hantingtonit, Ajzehauer, të rajonit, të Evropës dhe të mbarë planetit, veçanërisht të SHA-së. Një ndër vitetet më të vështira shqiptare ishte 1997-a vit i mbrapshtë që e sollën vetë shqiptarët dhe e çuan shtetin në buzë të greminës. Koshient për këtë gjëmë shqiptare vijnë edhe mendimet e gjeneral Qazimit por pasiguria politike e shoqëruar me shkatërrimin e ushtrisë, 600 mijë armë të lehta dhe automatike, 200 mijë pushkë, një milionë mina, 38 mijë pistoleta..., 770 gryka zjarri, 560 milionë fishekë, 3 milionë granata... një arsenal që lidhet me 1300 depo ushtarake. Shifrat nuk kanë të sosur dhe mbi të gjitha ishte një pasuri e çmuar e shqiptarëve. Kjo jo vetëm kërkon analizë të thellë dhe përgjegjshmëri. Politika duhet të japë llogari në radhë të parë para popullit. Dje, sot dhe nesër vetëm interesat tona kombëtare janë të trashëgueshme historikisht. Ndjenja e devocionit daton thellë në histori dhe i ka rrënjët tek frymëzimi dhe pasioni atdhetar me rrënjë iliro-arbërore, që ka në thelb shqiptarizmin.

Shpresat e fikura të shqiptarëve i ndezi që në shekullin e XV Gjergj Kastrioti në motin e madh të Arbërit dhe më tej Rilindasit e mëdhenj, idealistët e Kombit për të mbrtur në shekullin e XX ku pavarësia shqiptare ishte fryt i vet shqiptarëve dhe i miqve ndërkombëtare, edhe pse të paktë ishin për tu nderuar e respektuar, duke shprehur mirënjohje. E megjithatë kombi shqiptar do të eci dhe përparojë me dituri dhe vetëm me dituri.

Nuk është e rastit që gjeneral Qazimi i mëshon intelektualizmit dhe progresit pasi edhe fatet e këtij libri i ka projektuar në cilësinë e mendimit dhe produktivitetin që e bën lexuesin të vëmendshëm ndaj ngjarjeve më madhore të kombit. Gjeneral Qazimi i apasionuar që në rini pas leximit, kishte përvetësuar ndër të tjera edhe artin e lënë nga filozofët e mëdhenj sikurse ishte Sokrati, që thoshte në mënyrë kaq të spikatur: "Ka vetëm një të mirë: "Dituria" dhe ka vetëm një te keqe "Padituria". Prandaj si erudit i

(Vijon në faqen 7)

## LIBRI



ndriçuar me dituri dhe i apasionuar për të qenë në avantgardë të grupit shoqëror që i përkiste u bë udhërrëfyes dhe këto i ka dokumentuar me vepra. I tillë është edhe libri që sapo ka parë dritën e botimit, si një libër me vlerë.

Autori ndjek edhe zhvillimet aktuale të politikave botërore që po e çojnë njerëzimin në një rrugë pa krye, ndërkohë që vetë dobësimi i marrëdhënieve euro-atlantike nuk është një ogur i mirë për Ballkanin Perëndimor, ku SHBA-të shihen si garant të perimetrit të sigurisë. Përdorimi i forces demonstronhet pa kriter në botën e sotme dhe zjarrvënësia kanë qenë gjithmonë "hazër-xhevap" duke qenë larg paqebërjes dhe paqeruajtësve, duke injoruar parimet e pallatit të qelqitë njujorkez. Çdo ditë kur lexojmë vepra me vlerë që të ngelen në mendje, një maksimum e përbotshme na kujton Johann Wolfgang von Goethe, kolosin e mendjes, shpirtit, penës, sintezë e veprës, dritës që bekon deri në frymën e fundit: "Dritë, më shumë dritë". Kjo dritë është një llambë e ndezur për dritë për gjithë studiuesit. Për paralele historike e tillë është vepra plot dritë nga historia jonë, që shkruan gjeneral Qazimi, një vepër që ndriçon epokën luftarake të shqiptarëve. Autori ka synuar dhe ja ka arritur, që në librin e tij të bëjë përpjekje madhore për ta ndriçuar jetën dhe dimensionet luftarake të shqiptarëve. Librat për gjeneral Qazimin nuk shërbejnë si një stoli intelektuale dhe as për të zbuluar bibliotekat. Ato janë pasuri që duhen lexuar për të zbuluar mendjen njerëzore.

Libri ka qenë dhe ka mbetur bashkëudhëtar i Gjeneral Pëllumb Qazimit, në një udhëtim të gjatë ushtarak, në një botë me shumë të panjohura, por ai diti të eci në imaginatën e tij, me këmbëngulje e dashuri për profesionin duke i dhënë shpresë e dritë ditëve të vështira të shërbimit nën armë, duke përzënë monotoninë dhe mërzinë dhe duke e mbushur jetën me pasuri e trashëgimi intelektuale dhe për më tepër në vitet e fundit i dha edhe dimension nga fusha e diplomacisë.

Maksima proverbiale popullore shqiptare që thotë "pa të shkuar nuk ka të ardhme", është tashmë e vërtetuar, edhe pse historiani dhe analisti ushtarak dhe diplomatik nuk mund të jetë as shenjt dhe as hyjnor, por trashëgues i mençurisë të kultivuar në dekada, fryt i një të shkuare plot djersë e pasion për librat, që e shikon librin si thesar të çmuar duke pasuruar botën e brendshme të njeriut, veçanërisht për të kultivuar edhe më tej vlerat e dijes, kulturës dhe qytetarisë, edhe si kontribut i fuqishëm në kulturën kombëtare ushtarake shqiptare. Autori Qazimi ka një të shkuar të sukseshme dhe ka shumë për të treguar nga shkolla Skënderbeje dhe më tej Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerave dhe më vonë edhe Akademia e Shtabit të Përgjithshëm. Autori është produkt i shkollës, trupës pedagogjike dhe komanduese, vetdisiplinimit. Rreshti, kapanoni, "çohu", "shpejt", "tranazh", "rekrut", "gati-tu" kanë qenë për ushtarakët sinonim i jetës, si dhe formimi i gjithanshëm lidhej me "Shkollën e burrëritim" të parakohshëm.

Pëllumb Qazimi ka qenë student i Shkollës së Bashkuar por që arriti shpejt të bëhej elitare në studime dhe më tej një oficer i talentuar dhe oficer i përkul-

# PËLLUMB QAZIMI

## GJENERALI DHE DIPLOMATI

### PËR LUFTËN DHE SHQIPTARËT

shtuar të ushtrisë popullore. Në atë periudhë kur në bankat e shkollës ishte Pëllumb Qazimi, meritokracia nuk kishte nevojë as për miq dhe as për shokë e mbi të gjitha nuk pranonte "furka", për t'u mbajtur në këmbë. Ose do të ecje me këmbët e tua ose do rrëzoheshe dhe do të "thyeje kokën". Me tempin e një studiuesi të apasionuar gjeneral Qazimi vijoi gjithë trajnimet dhe kualifikimet, për t'ja mbritur në publikimin e librave-vlerë sikurse është edhe libri i tij më i ri "Lufta dhe shqiptarët". Autori Qazimi pulson me jetën qytetare shqiptare, shqetësohet për instrumentet e sigurisë sot, për çështjet e sigurisë që nuk mund të nënkontraktohen, për mbrojtjen e sovranitetit që kërkon jo vetëm ushtarë dhe buxhet mbrojtjeje që "kafshon" rëndë buxhetin e shtetit, si dhe diplomaci si faktor shumëfishues i sigurisë kombëtare.

Pëllumb Qazimi për 34 vite (1972-2006) ka qenë nën uniformë dhe me karrierë të gjatë drejtimi ushtarak, por dhe për 16 vjet si Ambasador i Shqipërisë në Kroaci e Slloveni, me fuqinë e intelektit dhe analizuesit historik ka sjellë një udhërrëfyes mbi pikëpaqet ushtarake, diplomatike, të ekspertizës në çështjet e sigurisë, vështrime përreth rajonit e më gjerë në historinë dhe politikbërjen, mbi diplomacinë e kulisave dhe mbi të gjitha mbi "lesson learned", mbi ndryshimet e tashme dhe të pritshme në ambjentin gjeopolitik, mbi vizionin e së ardhmes shqiptare, mbi sjelljet e qëndrimet politike e diplomatike, përballimin e sfidave dhe përmbushjes së pritshmërisë së publikut. Fakt është që vizionarët kanë qenë dhe kanë mbetur të rrallë, politikbërësit janë të shumtë, por ne kemi vetëm një Atdhe, në këtë botë globale kaq të paqëndrueshme. "Lufta dhe shqiptarët" i autorit Pëllumb Qazimi me recezentë të Ditmir Bushatit dhe Marenglen Kasmit vjen për lexuesin nën redaktimin plot elegancë të botuesit të shtëpisë botuese "Naimi" të redaktorit Naim Zoto, ashtu si dhe publikimet e njohura të kësaj shtëpie botuese. Një pjesëmarrje masive në Pallatin e Kongreseve mblogji promovimi e librit më të fundit të Pëllumb Qazimit "Lufta dhe shqiptarët" (më datën 7.11.2025), ku u fol gjerësisht për lufrat që shqiptarët kanë përballuar shekujve të historisë. Libri është një udhërrëfyes i domosdoshëm, jo vetëm për lexuesit e thjeshtë e të pasionuar pas historisë së luftërave, por edhe për ushtarakët, diplomatët, ekspertët e çështjeve të sigurisë dhe politikbërësit shqiptarë.

#### RRËNJËT STËRGGJYSHËRORE DHE NJË KARRIERË SINJIFIKATIVE E GJENERAL PËLLUMB QAZIMI

Pëllumb Qazimi është lindur më 21.10.1957 në fshatin Çepan të Skraparit. Ai erdhi në jetë në një familje të Skraparit, një trevë e njohur me ngjarje e kontribute në historinë tonë kombëtare. Pëllumbi lindi "rastësisht" në Çepan, pasi babai i tij, Xhaferi, ishte me shërbim si oficer kufiri në Sarandë dhe së bashku me nënën e Pëllumbit, Florien dhe djalin e madh, ndodheshin me disa ditë pushime në Çepan. Kështu, Pëllumbi, fëmijë i vogël, qëndroi rreth tre muaj në Çepan dhe mandej së bashku me prindërit dhe vëllain e madh shkuan në Zminec të Sarandës, ku babai i tij shërbente si oficer kufiri. Bazuar në të dhënat dokumentare, por dhe burimet gojore, të parët e fisit Qazimi të sotshëm, flitet se janë vendosur në Çepan të Skraparit rreth viteve 1820-1825. Gjyshërit Sali dhe Karafille kanë qenë njerëz fjalëpak, por punëtorë të ndershëm dhe të sakrificës. Familja e madhe është marrë me bujqësi, blegtori, si edhe me ndërtime. Gjyshi, ashtu si bashkëfshatarë të tij, gjatë viteve 1943-1944, ka ndihmuar partizanët përmes transportit të ushqimeve e municioneve.

Të njëjtën gjë, pavarësisht se ishte vetëm 13-14 vjeç, ka bërë edhe babai i Pëllumbit, Xhaferi. Familja e madhe e gjyshit, Saliut, krahas punës për të mbajtur familjen dhe pavarësisht pamundësive është shquar edhe për dëshirën që fëmijët të arsimohen sa më shumë. Pëllumb Qazimi është pjesë e një familje ushtarakësh. Babai, vëllai i madh dhe motra e madhe kanë shërbyer në radhët e ushtrisë. Po ashtu edhe një nga xhaxhallarët dhe të afërm të tjerë. Edhe pse u lind në Çepan, Pëllumb Qazimi në fshatin e origjinës së prindërve shkante vetëm gjatë pushimeve të verës. Pesë vitet e para Pëllumbi i kaloi në fshatin Zminec të Sarandës dhe mandej deri në moshën 15 vjeç në Llongo të Dropullit të Sipërm dhe

mandej në qytetin e Gjirokastrës.

Lëvizja lidhej me detyrat që kryente babai si ushtarak kanë ndikuar edhe në arsimin e Pëllumbit. Kështu arsimimin fillor e kreu në vitet 1964 - 1968 në gjuhën greke në shkollën fillore të Llovinës, Dropullit të Sipërm, ndërsa shkollën 8-vjeçare e kreu po në gjuhën greke në shkollën tetëvjeçare në Llongo të Dropullit të Sipërm, Gjirokastrë. Më tej vijoi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej" në Tiranë (1.9.1972-30.7.1976), shkollë që e përfundoi me rrezultate të shkëlqyera. Të sille të vëmendje se Pëllumbi në Shkollën "Skënderbej" njihet si skënderbegas Pëllumb Fodulli, pasi "Fodulli" ishte mbiemri i familjes së madhe deri atëherë dhe në ato vite mbiemri ishte ndryshuar në "Qazimi". Në moshën 20 vjeçare, më 1.1.1977 deri më 30.7.1980 vijoi studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në specialitetin "Zbulim". Në vitin 1981 titullohet oficer dhe shërbeu në ish shkollën e zbulimit të ushtrisë si komandant toge dhe instruktor stërvitjeje. Pas përfundimit të Akademisë së Mbrojtjes në vitin 1991 u emërua instruktor i zbulimit me trupa në Drejtorinë e Zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm. Në vitet në vijim ai është emëruar shef i degës së zbulimit me trupa në Drejtorinë e Zbulimit, zëvendës drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Informativ Ushtarak dhe shef i Zbulimit Ushtarak për të mbërritur deri në detyrën madhore dhe shumë të përgjegjshme të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, në dy mandate, në periudhën shtator 2000 - tetor 2006.

Në vitin 1992 kapiteni I-rë Pëllumb Qazimi me urdhër të kryeministrit u ngarkua me detyrën e kryetarit të komisionit ndërministror për refugjatët, detyrë që e ushtroi për 6 vite rresht dhe që lidhej me përgatitjen e vendit për pritjen e refugjatëve në rast të një konflikti të mundshëm në Kosovë. Gjatë krizës së vitit 1997, me ardhjen e trupave ndërkombëtare për vendosjen e qetësisë në vend, pala shqiptare organizoi një strukturë të veçantë, e cila koordinonte e bashkëpunonte me shtabin drejtues të operacionit "Alba" dhe kolonel Pëllumb Qazimi u emërua zëvendës komandant për palën shqiptare. Pëllumb Qazimi nuk është vetëm një ushtarak i spikatur dhe një profesionist i diplomacisë por edhe një studiues serioz i letrave veçanërisht i fushës së mendimit ushtarak e diplomatik. Ai është autor i një varg studimesh dhe artikujsh në shtypin ushtarak shqiptar e të NATO-s dhe i kumtesave të mbajtura në veprimtari shkencore brenda e jashtë Shqipërisë. Ai ka qenë anëtar i Redaksisë së Fushës së Zbulimit dhe të Ushtrive të Huaja të FEUSH-it. Me vullnet dhe këmbëngulje arriti që të mbrojë doktoraturën në periudhën kur ka qenë ambasador në Kroaci dhe që është inkurajuar e këshilluar nga një kolos i mendimit, ilirologu dhe albanologu Aleksandar Stipčević (ilirolog, historian, arkeolog dhe studiues arbëresho-kroat), si edhe nga albanologu i njohur Zef Mirdita. Pëllumb Qazimi ka publikuar: "Histori e ushtrisë shqiptare: 1912-1991", që është një vepër tërësore, ku autori Qazimi i ka bërë një paraqitje të gjallë të historisë së ushtrisë sonë.

Së fundi gjeneral Pëllumb Qazimi ka sjellë librin e tij më të ri "Lufta dhe shqiptarët". Natyrshëm planet publikuese do të vijojnë, pasi lexuesi ushtarak dhe diplomat do të donin edhe më shumë për përvojën, si dhe mendimin ushtarak dhe diplomatik të Pëllumb Qazimit. Është fakt se ushtaraku madhor Gjenerallejtnant Pëllumb Qazimi është një figurë e dashur ushtarake dhe diplomatike e jo vetëm nga strukturat e mbrojtjes dhe diplomacisë por edhe më gjerë. Gjatë karrierës së gjatë ushtarake nuk punoi kurrë për dekorata dhe vlerësime, por ato janë të natyrshme dhe të domosdoshme për një forcë ushtarake serioze dhe për më tepër anëtare e organizatës më të madhe të sigurisë në botë, NATO-s. Mban dekorata të larta të shërbimit ushtarak dhe më gjerë. Në nëntor 2024, Gjenerallejtnant dhe Ambasador Pëllumb Qazimi, është vlerësuar me titullin "Qytetar Nderi i Skraparit", nga Këshilli Bashkiak i Skraparit.

Nga skeda e dosjes gradimet e gjeneral Qazimit e kanë fillësën me gradën Kapiten i I-rë (urdh.nr.110 dt.27.11.1991), mandej major (8.12.1992), nënkolonel (7.7.1993) dhe kolonel (17.1.1995). Me marrjen e gradës gjeneral brigade në 14 shtator 2000, disa ditë

(Vijon në faqen 9)

## PROMOVIMI

Në ditëlindjen e 65-të, kryeredaktori i "VETERANI"-it promovonon librin e 30-të me poezi dhe tregime të zgjedhura



e media prestigjioze ndërkombëtare; miku dhe bashkëpunëtori im i ngushtë Sakip Cami prej më se katër dekada, bashkëautorë i 6 monografive letare dhe zëvendëskryeredator i gazetës "Veterani", ndër poetët, prozatorët dhe publicistët e mirënjohur tashmë; Emmy Krosi – poete, prozatore dhe ndër zërat më të spikatur të kritikës së sotme letrare, Shpendi Topollaj – publicist, poet, prozator dhe kritik i njohur letrar; poeti dhe publicisti i njohur Nexhbedin Basha redaktorja e këtij libri – zonja fisnike e me inteligjencë të rrallë Nadire Kadaraku, si dhe kuadri dhe drejtuesi ekselente Irfan Dashi, etalon i ndershmërisë dhe përkushtimit qytetar (auror i dy librave), të cilët me ekspertizën e tyre më krijuan besimin për ta botuar këtë libër me poezitë dhe tregimet e mia të zgjedhura.

Dhe ja disa nga vlerësimet e tyre:

## ODA DIBRANE SI INSTITUCION VLERASH NË POEZINË E HALIL RAMËS

•Autori i 30 librave vlerësohet me titujt "NDERI DHE KRENARIA E OBVLP", "FISNIKËRIA E BASHKËSISË DIBRANE" dhe "MIRËNJOHJA TIRANASE"...

**Nga Nexhbedin Basha**  
Gazetar & poet, kritik letrar

Në ditëlindjen e tij të 65-të, më 28 Tetor 2025, gazetari dhe shkrimtari Halil Rama përjetoi dy gëzime: promovimin e librit të tij të 30-të "ODA DIBRANE" (me poezi dhe tregime të zgjedhura dhe vlerësimin me titujt "MIRËNJOHJA TIRANASE"; "FISNIKËRIA E BASHKËSISË DIBRANE" dhe "Nderi e krenaria e OBVLP", nga tri shoqatatat përkatëse, më të mëdhatë e më dinjitozet në metropolin shqiptar.

Qoftë dhe vetë motivacionet e titujve:

"Në vlerësim të kontributit të dalluar në evidentimin e figurave dhe personaliteteve të jetës artistike, patriotike dhe atdhetare të trevës së Dibrës, shkrimtarit, publicistit, gazetarit dhe poetit, si dhe lëvrujesit të mjaft skenarëve, programeve dhe dokumentarëve televizivë." (Nga Bashkësia Dibrane) dhe "Gazetar, shkrimtar me vlera të veçanta. Me një aktivitet të gjatë e të çmuar në fushën e gazetarisë, publicistikës dhe më gjërë, për



kontribut të veçantë ndaj komunitetit dhe Shoqatës 'Tirana' në pasqyrimin dhe promovimin e kulturës dhe traditës tiranase. Për pasqyrimin me profesionalizëm nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike, të shumë aktiviteteve të shoqatës" (nga Shoqata "Tirana") që u publikuan në këtë event mbresëlënës nga kryetarët e dy shoqatave: Prof. asoc. dr. Saimir Shatku dhe Prof. Dr. Ruzhdi Keçi, reflektojnë produktin mediatic dhe letrar të Halil Ramës në ruajtjen e kujtesës historike dhe dokumentimin e vlerave kombëtare.

Po në këtë linjë që edhe vlerësimi i Halil Ramës nga OBVLP me CERTIFIKATË MIRËNJOHJE me motivacionin: "Për drejtimin prej 25 vitesh me kompetencë e profesionalizëm të faqes 'VETERANI', duke e bërë atë konkurrese dhe dinjitoze në tregun mediatic shqiptar, si evidentuese dhe prom-

ovuese më e mirë e vlerave të LANÇL dhe të historisë sonë kombëtare në tërësi, dhe të personaliteteve të saj të të gjitha kohërave.", që ju dorëzua nga kryetarja e kësaj organizate Tatjana Parllaku Çarkaxhiu.

Në takimin promovues që u mbajt në Kinema "Maks Velo" Tiranë, mes qindra miqve, familjarëve e të afërmëve të këtij autori qenë dhjetra personalitete akademikë e të letrave që vlerësuan krijimtarinë e tij dhe veçanërisht librin "ODA DIBRANE".

Vetë autori Rama, ndër të tjera tha se: "Në këto 35 vite të shoqërisë së lirë ka një fluks të madh potetësh, të vjetër e të rinj, poezinë e të cilëve e ndeshim thuasje çdo ditë në rrjetet sociale..., por mua, nga dilema për t'u bërë ose jo pjesë e kësaj oqeanopoezie, më 'shpëtuan' miqtë mi: Dr. Mujë Buçpapaj – ndër poetët dhe analistët shqiptarë më të vlerësuar nga intitucone

**PROF.DR. SAIMIR SHATKU:** "Ky libër bart vlera shumëdimensionale, jo vetëm për lëndën tejet të pasur e të larmishme, por parasëgjithash për stilistikën e veçantë të këtij autori, gjuhën e pasur dhe mjetet shprehëse domethënëse. Kësisoj mund të konkludojmë se ky është një libër sa intrigues aq edhe mbresëlënës. Mesazhi këtu përcillet qartë sidomos tek poezia "ODA DIBRANE": "Oda dibrane:/ Besa e burrit/, Qëndresa e trimit/, Përkrahja e mikut/, Çerdhe e patriotizmit/.... Oda dibrane/ Mençuria e fjalës/ Urtësia e të moshuarve/ Fundi i armiçësive/ Kënaqësia e muhabetit/ Burim i humorit/ Shpërthimi i këngës/ Sheshi i kërcimit.../ Jehona e të qeshurit..." Në këtë poezi që autori e ka vendosur jo pa qëllim titull të librit evidentohen qartazi variacionet poetike në formë mozaiku që shkrihen në kodet nëntekstuale nëpërmjet të cilave ai i ngre një kult botës dibrane, nderit, dinjitetit, virtytit, arketipit social, etik dhe filozofik të dibranit që motivohet nga zgjuarsia, maturia, etj".

**SHPENDI TOPOLLAJ:** Halil Rama, mbetet një nga zërat më të fuqishëm dhe më të spikatur në evidentimin e vendit që Dibra dhe dibranët zënë në rrjedhat historike të Shqipërisë. I urtë dhe i thjeshtë në sjellje, dhe pa kurrfarë dëshire për t'u dukur, gazetari, poeti dhe shkrimtari i plot 30 librave, dhe do të shtoja; veprimtari Halil Rama, Mjeshtër i Madh, gjithë dijet, kulturën dhe përvojën e tij, i ka vënë gjithmonë

(Vijon në faqen 10)



## FJALA

# Halil Rama është një nëpunës ekselent



Nga Irfan DASHI\*

**Me penën e zemrës dhe ngjyrat e shpirtit në krijimtarinë tënde ke promovuar vlera duke bërë të lumtur shumë njerëz. Ndërkohë që, sot jetojmë në një botë ku njerëzit po largohen për ditë e më shumë nga njeri-tjetri.**

**Uroj me shpirt që:  
- Pasioni dhe enegjia për të shkruar të mbeten të pashtershme tek ti.**

## Të nderuar pjesëmarrës! I nderuar miku im Halil!

Në këtë event po kremtojmë dy gëzime tuaja; 65 vjetorin e lindjes dhe promovimin e librit 30-të.

Në moshë më të re të gjithë kemi ëndrra, ndërsa në këtë moshë kemi kujtime. Më të rinj vrapojmë pas jetës, ndërsa vjen një kohë që ndalemi për ta kujtuar atë.

Kur arrin në këtë moshë jo vetëm bëhesh nostalgjik për kohën që ka ikur, por dhe përipiqesh të bësh një bilanc të asaj se çfarë ke bërë në jetë.

Njeriu duhet të përipiqet të lërë një shenjë në jetë. Varet si e ke jetuar jetën. Jo sa vjet ke jetuar. Dhe ju i dashur Halil keni se për çfarë të krenoheni, sepse këtë bilanc e keni me plot arritje, pasi keni lënë gjurmën e vulën tuaj.

Keni lënë një emër të mirë dhe një vepër të krijuar me shumë punë, mund dhe sakrificë.

Suksesi është misioni yt. Dhe për ta arritur atë këmbëngulja është arma jote. "Masa e vlerës së një njeriu është puna dhe jo pasuria"- ka thënë Benxhamin Fraklin.

Dhe ju jeni mëshirimi më i mirë i kësaj thënie.

Profesionistë të fushës me skrupulozitet e bënë analizën e krijimtarisë tuaj.

Në këtë drejtim ju e keni krijuar profilin tuaj si në gazetari dhe në letërsi.

Prandaj për mua si dashamirës i letërsisë ose le të them si një lexues i vëmendshëm nuk më mbetet gjë të them, përveçse ta konsumoj atë.

Por si dëshmitar në vetë të parë i procesit të ngjizjes e krijimit të pothuajse të gjithë krijimtarisë së Halilit, që nga monografitë dhe deri tek libri që promovojmë sot "Oda Dibrane" ku në qendër të tij është poezia,

kjo gjini e letërsisë ku bota e brendshme, ndjenjat e frymëzimi shprehen në vargje mund të dëshmoj për pasionin, zellin e përkushtimin me të cilin Halili punon.

Por unë dua të them dy fjalë për një dimension tjetër shumë të rëndësishëm të jetës Halilit, atë të qenit njeri, profesionist dhe koleg.

Çfarë do të thotë të jesh njeri?!

Po mjaftohem të citoj profesorin e shkencave kompjuterike Raundy Pausch (Rendi Paush), i cili në librin e tij "Leksioni i fundit" shkruan:

"E para në jetë është të jesh njeri dhe zero pas, të aftësive dhe dhuntive të tjera i shtojnë vlerën njëshit.

bisedojmë edhe për letërsinë e shumë çështje të tjera që na preokupojnë.

Po si do ta përshkruaja unë Halilin si profesionist, si koleg e bashkëpunëtor?!

Pa hezitim do të thoja: Halili është një nëpunës ekselent.

Ai është një profesionist i aftë, një njeri tepër korrekt dhe i përkushtuar në punë. Bashkëpunues, luajal dhe i gatshëm për të ndihmuar kolegët më të rinj.

Profesionalizmi, integriteti, dinjiteti, kolegialiteti e luajaliteti janë cilësi, të cilat është vështirë ti gesh të mishëruara sot ndër nëpunësit e administratës publike.

Çdo gjë e ka një shpjegim pse ndodh. Dhe pse Halili manifeston këto cilësi e ka patjetër një shpjegim.

Është edukata familjare që ka trashëguar si edhe formimi e shkollimi i tij që e kanë formësuar si të tillë.

Halili ka krijuar prej kohësh personalitetin e tij me punë. Ai është dinjitoz. Halili është person me histori personale.

Për këto flet jeta dhe vepra e tij.

Në sektorin ku punojmë sëbashku jemi përpjekur të bëjmë më të mirën për funksionimin e Njësave Administrative të Bashkisë Tiranë.

Nuk kemi anashkaluar apo neglizhuar asgjë. Aq më pak të kemi vegjetuar. Shpresojmë e besojmë se kemi vendosur një gur themeli veçanërisht në formësimin e strukturave komunitare në qytet dhe fshat.

Ndjem me fat që në udhëtimin tim të jetës kam takuar një personalitet si Halili.

Respekti meritohet, ndershmëria vlerësohet dhe besnikëria shpërblehet.

Të shpreh gjithë mirënjohjen time për bashkëpunimin korrekt që kemi patur.

## I dashur Halil!

Me kalimin e moshës pamja mund të zbehet, flokët mund të thinjen, por personaliteti nuk ndryshon kurrë.

Me penën e zemrës dhe ngjyrat e shpirtit në krijimtarinë tënde ke promovuar vlera duke bërë të lumtur shumë njerëz. Ndërkohë që, sot jetojmë në një botë ku njerëzit po largohen për ditë e më shumë nga njeri-tjetri.

Uroj me shpirt që:

- Pasioni dhe enegjia për të shkruar të mbeten të pashtershme tek ti.


- Shumë urime për 65 vjetorin e lindjes.

- Festofsh edhe 100 vite të tjera!

- Qofsh një bashkëshort, baba e gjysh i lumtur!

## Ju faleminderit!

\*Fjalë përshëndetje me rastin e 65 vjetorit të lindjes dhe promovimit të librit të 30-të të Halil Ramës.



Nëse nuk je njeri, pra mungon njëshi në fillim, të gjitha zerot pas tij nuk kanë asnjë vlerë".

Dhe ti Halil para së gjithash je njeri.

Po ku më mirë se në marrëdhënie pune mund ta njohësh një njeri?!

Në punë e njeh tjetrin 360 gradë.

Them se ne e njohim njeri-tjetrin mirë.

Prej vitesh jemi kolegë. Nuk kemi mbetur vetëm të tillë, por jemi bërë shokë e madje miq të mirë. Ndajmë shumëçka bashkë.

Nuk flasim vetëm për problematikat e punës, por

## PËLLUMB QAZIMI GJENERALI DHE DIPLOMATI PËR LUFTËN DHE SHQIPTARËT

(Vijon nga faqja 7)

më pas ai, me dekret të Presidentit të Republikës u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, duke marrë gjatë asaj periudhe trevjeçare edhe gradën gjeneral major (14.11.2001). Në shtator të vitit 2003 Pëllumb Qazimi me dekret të Presidentit të Republikës u dha mandati i dytë si shef i Shtabit të Përgjithshëm, përfshi edhe gradën gjeneral lejtant (me dekret nr.3952 dt.30.9.2003). Gjeneral Pëllumb Qazim është i martuar me Fatbardha Qazimi dhe kanë tre fëmijë, dy djem Irisi dhe Albi si dhe një vajzë Alisia.

Arsimimi i gjeneral Qazimit: 1964-1968, përfunduar shkollën fillore në gjuhën greke në Llovinë, Dropulli i Sipërm, Gjirokastër; 1968-1972, përfunduar shkollën tetë vjeçare në Llongo, Dropulli i Sipërm, Gjirokastër; 1972-1996 përfunduar shkollat ushtarake në Tiranë: Shkolla e Mesme e Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej" në vitin 1976; Shkolla e Bashkuar e Oficerëve-Akademia Ushtarake në vitin 1980, diplomuar në vitin 1981; Akademia e Mbrojtjes në vitin 1991; Kolegji i Mbrojtjes në vitin 1996; 1999-2000 përfunduar studimet pasuniversitare për siguri globale-diplomaci e mbrojtjes në Kolegjin Ushtarak Mbretëror, Universiteti Cranfield, Mbretëri e Bashkuar; 2001 fituar nivelin master "Msc", në gjuhën angleze, për temën "Studim për bashkëekzistencën në Kosovë në krahasim me raste të tjerë", Kolegji Ushtarak Mbretëror, Universiteti Cranfield, Mbretëri e Bashkuar; 2012 Doktor i Shkencave, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Zagrebit, mbrojtur në gjuhën angleze për tezën "Historia ushtarake shqiptare dhe influencat e huaja, 1912-1991". Trajnime dhe kualifikime: 1992 ndjekur kursin ndër-

kombëtar për "Refugjatët", Hungari; 1993 ndjekur kursin për "Ligjshmërinë Ndërkombëtare për Refugjatët", Itali; 1994 ndjekur kursin për "Orientimin dhe planizimin e operacioneve", Turqi; 1995 ndjekur kursin tre mujor "Zbulimi Strategjik", SHBA; 1996 ndjekur kursin e NATO-s "Oficer shtabi për operacionet", Hollandë; 1998 ndjekur kursin për "Ligjin e Luftës", Itali; 2018 ndjekur kursin katër mujor të diplomacisë ekonomike për Shqipërinë, Qendra për Zhvillim Ndërkombëtar, Universiteti i Harvardit, SHBA. Publikime, etj. 2002-2023 publikime në revista e botime shqiptare dhe të huaja, kontribute në seminare dhe konferenca brenda dhe jashtë vendit; 2007 bashkëautor i studimit: "Këndvështrim nga Shqipëria-Studim për vlerësimin e kërcënimeve të sigurisë rajonale në Ballkanin Perëndimor"; 2012 autor i librit në gjuhën angleze "Albania, the Military and the Foreign Influence, 1912-1991", botuar në Zagreb; libri i përkthyer e botuar në gjuhën kroate në Zagreb në vitin 2013 me titull "ALBANIJA - vojska i strani utjecaji 1912. - 1991."; libri i botuar në gjuhën shqipe në Tiranë në vitin 2013 me titull "Histori e Ushtrisë Shqiptare 1912-1991", ribotuar me të njëjtin titull në vitin 2024; libri i botuar në gjuhën shqipe në vitin 2025 me titull "Lufta dhe Shqiptarët"; përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe i librit të autorit sloven Peter Štoka, botuar në vitin 2024, me titull "Shqiptarët e Lashtë dhe Krijimi i Istrias"; Ligjërata në konferenca e institucione të ndryshme në Shqipëri, Gjermani, Kroaci, Maqedoni e Veriut, Slloveni, Kosovë. Pëllumb Qazimi ka pasur një karrierë ushtarake mjaft të sukseshme. Kështu në 1980-2000 ka kryer detyra të ndryshme në Ushtrinë shqiptare; 1992 Kryetar i Komisionit Ndërmin-

istror për Refugjatët; Shtator 2000 - tetor 2006 (gjeneral brigade, gjeneralmajor, gjenerallejtant) Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë; Dhjetor 2006 konsulent për sigurinë në Institutin për Demokraci e Ndërmjetësim (IDN), Tiranë dhe kryetar i bordit botues të Revistës "Çështje të Sigurisë - Security Issues", botim i IDN; Gusht 2007-2014 ambasador i Shqipërisë në Kroaci; 2008-2010 ambasador i Shqipërisë në Bosnjë dhe Hercegovinë (jo rezident); 2014-2023 ambasador i Shqipërisë në Slloveni. Gjeneral Qazimi nuk punoi kurrë për dekorta, medalje e urdhëra. Ndërkohë që në këtë periudhë gjeneral Qazimi e vendosi "me kokë lartë" problematikën e vlerësimit me urdhër për dekorimet, ndërkohë që është vlerësuar me këto: Medalje e Punës (urdh.5152 dt.28.2.1974) nga Presidiumi Kuvendit Popullor, dy Medalje të Shërbimit Ushtarak, Medalje e Mirënjohjes, Medalje e Artë e Shqiponjës, Medalje e Karrierës, dy Medalje të Shërbimeve të Shquara, Medalja e Urdhërit të Skënderbeut, Medalja e Legjionit të Meritës (SHBA) si dhe Urdhëri i Dukës Branimir (Kroaci). Pëllumb Qazimi është një njohës i shkëlqyer i gjuhëve anglisht dhe greqisht. Burimet e studimit: Dosja personale "Gjeneral Lejtant Pëllumb Qazimi" në QPR, MM, Tiranë; FEUSH, Prishtinë, 2020, faqe 734; Kujtim Halili, Fjalor Biografik Ushtarak, Tiranë, SHB Emal, 2006, faqe 141, Zaho Golemi, Kush e ka drejtuar SHP, Ilmi S. Qazimi, Çepani, Monografi, 2015, perioidike të gazetave të përditshme, "Telegraf", "Panorama", "Sot", "Revista "Mbrojtja", Gazeta "Ushtria", publikime në dy dekada; Të dhëna arkivore AQFA, Buletini Arkivor Ushtarak, etj.

## PROMOVIMI

# ODA DIBRANE SI INSTITUCION VLERASH NË POEZINË E HALIL RAMËS

(Vijon ng faqja 8)

në shërbim të çështjeve madhore të Kombit tonë dhe domosdoshmërisë së instalimit të demokracisë të vërtetë. Është e njohur për lexuesin qysh herët veprimtaria e tij, si letrare, ashtu dhe publicistike, e cila pasqyrohet edhe te libri i tij me poezi dhe tregime që po paraqitet sot, me titullin 'Oda Dibrane'.

**EMMY KROSI:** "Halil Rama është një krijues me mendim e individualitet të spikatur...Libri i tij i 30-të 'Oda Dibrane' është një zbritje në 'terrenin e fjalës magjike' – poezinë, si një hap të ri krijues pas veprës së tij publicistike. Përmes poezisë dhe prozës kërkon të gjejë dimensionin më shpirtëror të vetvetes. Libri 'ODA DIBRANE' ka strukturë të qartë dhe të menduar, i ndarë në gjashtë cikle tematike që përfshijnë historinë, vendlindjen, familjen, personalitetet, motivet popullore dhe meditimet. Kjo ndarje tregon një krijues të ndërjegjshëm për materialin e vet poetik, që kërkon të shprehë jetën, kujtesën dhe ndjenjën kombëtare në shumë drejtime. Në të gjenden motive baritore dhe folklorike që e lidhin me traditën e Dibrës dhe me poezinë e Naim Frashërit. Vargjet kanë ngrohtësi shpirtërore dhe tingëllimë melodike, që mbartin sineritet e dritë brenda fjalës. Kështu Halil Rama arrin të bashkojë penën e publicistit me ndjeshmërinë e poetit, duke ndërtuar një univers ku bashkëtojnë historia, familja, dashuria, atdheu dhe meditim. Ai e ngre Odën Dibrane në institucion vlerash, duke sjellë një pasuri të re për letërsinë bashkëkohore shqiptare, që ruan rrënjët e traditës, por i flet me gjuhë të ndjeshme dhe moderne shpirtit të sotëm".

**NADIRE KARADAKU:** "Libri 'Oda Dibrane' është kurorë e pjekurisë krijuese të autorit Halil Rama. Është një vepër e larmishme në tematikë dhe formë, që bashkon traditën me risinë, duke e bërë poezinë e tij të jetë e kuptueshme, e pastër dhe me ritëm të gjallë. Poezia e tij dallohet për gjuhën e thjeshtë, por të ngrohtë, që e bën librin të lexohet me një frymë dhe të lërë mbresa të thella tek lexuesi. Sidomos te poezitë familjare ("Nëna ime më e mira", "Fjalëpak e punëshumë babai im") dhe te ato kushtuar personaliteteve të njohura shqiptare si "Haki Stërmilli", "Margarita Xhepa", "Shefki Karadaku", "Teodor Laço", "Sokol Oll-dashi" e "Hakis Ndreu". Në këto poezi shfaqet respekti i thellë i autorit ndaj figurave që kanë lënë gjurmë, duke gërshetuar frymën e poezisë shqiptare me elementë të poezisë botërore. Lirikat e tij mbështeten në filozofi jete, të ndërtuara mbi kultin e së bukurës dhe të përjetimit njerëzor. Në librin 'Oda Dibrane' Halil Rama shfaqet si poet i ndjenjës, i respektit dhe i përkushtimit, duke i dhuruar lexuesit një vepër që ndërthur dashurinë për familjen, traditën dhe artin."

**SAKIP CAMI:** "Halil Rama, vjen me këtë libër si poeti i ndjenjës, kujtesës dhe dashurisë që kthen jetën në poezi. Libri 'Oda dibrane' është një mozaik ndjenjash njerëzore dhe



një pasqyrë e shpirtit krijues dibran, më shumë se një objekt kritik akademik. Në të dallohet dimensionin njerëzor i poezisë, ku dashuria për nënën, bashkëshorten, fëmijët, miqtë dhe idealet atdhetare formojnë bosh-tin tematik të veprës. Kjo tregon që poeti këndon me shpirt dhe e ndërton botën e tij poetike mbi ndjenjën, kujtesën dhe përkushtimin. Poezia e Ramës është intime dhe universale njëkohësisht, sepse lind nga përjetimet personale, por prek ndjenja që u përkasin të gjithëve".

**IRFAN DASHI:** "Si dëshmitar në vetë të parë i procesit të ngjizjes e krijimit të pothuajse të gjithë krijimtarisë së Halilit, që nga monografitë dhe deri tek libri që promovojmë sot "Oda Dibrane", dua të veçoj se në qendër të tij është poezia, kjo gjini e letërsisë ku bota e brendshme, ndjenjat e frymëzimi shprehen në vargje që dëshmojnë për pasionin, zellin e përkushtimin me të cilin Halili punon".

Si autori i këtij reportazhi unë do të thoja se poezitë dhe tregimet e zgjedhura të autorit Halil Rama ("Dashuri të stuhishme në plazhin e gjeneralit", "Zonja me tri shtetësi dhe tri shtëoi", "Rebelimi i qenit mavis"), etj nuk janë thjesht kombinim tingujsh apo shkrimesh, por trashëgimi, dritë dhe udhërrëfyes i shpirtit. Në 30 librat e Halil Ramës, fjala bëhet mbajtëse e kujtesës kolektive, përmbledh histori, ndjenja, heroizma dhe dhimbje të brezave të kaluar, duke jetuar dhe fluturuar tek lexuesi si një pasqyrë e së kaluarës dhe një dritë për të ardhmen.

Si autori i 30 librave ai uvlerësua edhe me titujt "FISNIKËRIA E BASHKËSISË DIBRANE" dhe "MIRËNJOHJA TIRANASE"... Ndryshe nga ndonjë skeptik autodidakt që nga xhelozia e shfrenuar e akuzon dhe fyen në rrjetet sociale, unë dua të pohoj dhe vlerësoj se Halil Rama – "Mjeshtër i Madh" dhe "Qytetar Nderi i Bulqizës", profili krijues i të cilit është botuar edhe në veprat madhore të shkrimtarit filozf Zekeria Idrizi "Portrete shkrimtarësh" (fq.195-199) dhe "Jetëshkrime dhe vepra miqsh e shokësh të shquar" (fq.126-129)

të Prof. dr. Hajri Shehut, në librat e tij të fundit "40 vepra letrare të 40 autorëve të skaner" dhe "Dibra dhe dibranët në panteonin e vlerave", vjen si promovuesi më i mirë i veprës letrare të shkrimtarëve dhe artistëve dibranë që renditen me elitën krijuese të kombit, si: Haki Stërmilli, Muharrem Xhediku, Hakis Ndreu, Prof. dr. Bujar Kapexhiu, prof. dr. Fatmir Terziu, Ahmet Prençi, Dr. Hajri Mandri, Lutfi Hanku, Hysen Dervishi etj, si dhe të poetëve dibranë: Sakip Cami, Barie Cupi, Avni Ndreu, Demir Rusi, e Hamdi Skeja dhe të monografive për Naim Plakun e Musa Riçkun të autorit Shaqir Skarra. Ndërsa në disa poezi të librit të tij të 30-të përcjell vlerat e Odës dibrane si institucion më vehte.

## VLERESIMI ME TITUJ NDERI

Vlerësimi i Halil Ramës me titujt "Mjeshtër i Madh", "Qytetar Nderi i Bulqizës", "Ambasador i Paqes", "Fisnikëria e Bashkësisë Dibrane në Tiranë", "Mirënjohja tiranase" etj, referuar motivacioneve të institucioneve shtetërore e shoqatave përkatëse kanë si emërues të përbashkët produktin e tij mediak si gazetar dhe redaktor i politikës dhe kulturës për 15 vjet rresht në gazetën e mëdha të përditshme "BULEVARD", "ALBANIA" e "RILINDJA DEMOKRATIKE" (1998-2013) si dhe 15 vitet e fundit, në analizat, komentet, reportazhet e dossier-ët e botuar në të përditshmet kombëtare "PANORAMA", "GAZETA SHQIPTARE", "TELEGARF", "ILLYRIA", "DIELLI", "BOTA SOT" e në të përjavshmen letare kulturore prestigjioze "NACIONAL, prej dy dekada në gazetën periodike "VETERANI" e "BULQIZA" (të themeluara dhe të drejtuar prej tij), si dhe në produktin letrar të konkretizuar në 30 libra të botuar e promovuar bujshëm, ku vetëm të fundit janë përcjellë me parathënie e pashënje nga personalitete akademike e të letrave si: akademik Shaban Sinani, prof.Bujar Kapexhiu-Nderi i Kombit, prof.dr. Eshref Ymeri, prof. dr. Fatmir Terziu, prof.asc. Bernard Zotaj, prof.asc. Zaho Golemi etj.

Përveç botimit dhe promovimit

të 30 librave, (gjashtë me b/autor Sakip Camin dhe një me b.autori Ju Sh.Skarra), vetëm këtë vit Halil Rama ka redaktuar dhe ka qenë organizator e referuesi i parë në promovimin e librave: "DINASTIA DOMI E CERENIT TË KALASË SË DODËS" e autorit Tajar Domi; "FSHATI YNË LUBALESHI" i autorit Vebi Musta dhe "PO KTHEHEM NË HOTESH" i autorit Skënder Murrja.

Falë aftësive profesionale (edhe si fitues i titullit "AVOKAT" me License nr. 7979, dt.31.10.2014 – dhënë nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, pas mbarimit të Shkollës përkatëse dhe nënshtrimit të promovimit) që prej 15 vitesh H.Rama është i punësuar me statusin ligjor të nëpunësit Civil në Bashkitë Kamëz dhe Tiranë, me vlerësime vjetore të performancës "Shumë mirë".

## PËRFUNDIMI

Me intuitë profesionale dhe ndjenjë artistike, moderator i këtij eventi Dëfrim Met'hasani i dha këtij momenti gjallëri, emocion dhe dinjitet. Ai nuk ishte thjesht moderator i një aktiviteti, por bashkëudhëtar në rrugën e kujtesës së Halil Ramës, duke i dhënë fjalës ritëm, zë dhe shpirt. Në atë paradreke, dy Mjeshtra të Mëdhenj – Halil Rama dhe Dëfrim Met'hasani – u bashkuan në një fjalë të përbashkët: dashurinë për njeriun, për artin dhe për Shqipërinë.

Po ashtu Kryetarja e Bashkisë Bulqizë, Festime Mjeshtri, u bë pjesë e një momenti domethënës për kulturën dibrane dhe mbarëshqiptare – promovimit të librit "Oda Dibrane" të poetit e studiuesit Halil Rama. Ajo tha se ky vëllim, i botuar në 65-vjetorin e autorit, është një himn ndaj njerëzve të shpirtit, miqësisë dhe rrënjëve tona kulturore.

Vetë autori H.Rama shprehu mirënjohje për zërat që e ngritën në kult ndjenjën dhe në institucion vlerash ODEN DIBRANE – Liri Rasha e njohur si pasaporta artistike e Dibrës, këngëtar i njohur dibran Bledar Kaca dhe për aktorin, regjisorin e skenaristin e mirënjohur Llesh Nikolla që interpretoi artistikisht disa poezi të librit "ODA DIBRANE".

FJALA

# SHPENDI TOPOLLAJ: HALIL RAMA NË 65 VJETORIN E TIJ TË LINDJES



Vlerat e larta atdhetare të dibranëve në histori, por edhe mençurinë, besnikërinë, mikpritjen dhe ndershmërinë e tyre, ndofta më mirë se kudo, i gjejmë të formuluar te përmbledhja “Kanuni i Dibrës” dhe shembujt ilustrativ aq domethënës që e shoqërojnë atë. Por, kushdo që i ka njohur nga afër ata, e di mirë, se virtytet njerëzore të banorëve të asaj treve dhe ngjarjet trimërore në mbrojtje të interesave të Shqipërisë, nuk kanë të sosur, çka duhet qartazi edhe te personalitetet që kanë dalë nga gjiri i saj. Kudo ku ka shkuar dibrani, qoftë atje ku e kanë përplasur dallgët e fatit, qoftë në kërkim të një jete më të mirë, po atje, tek ato “Nëntë malet e Dibrës” e ka pasur mendjen dhe ka bërë ç’ka mundur, t’i nderojë dhe t’i përfaqësojë denjësisht ato. Kanë folur e kanë shkruar plot shkrimtarë, poetë e intelektualë, por dua të besoj se miku ynë Halil Rama, mbetet një nga zërat më të fuqishëm dhe më të spikatur në evidentimin e vendit që Dibra dhe dibranët zënë në rrjedhat historike të Shqipërisë.

I urtë dhe i thjeshtë në sjellje, dhe pa kurrfarë dëshire për t’u dukur, gazetari, poeti dhe shkrimtari i plot 30 librave, dhe do të shtoja; veprimtari Halil Rama, Mjeshtër i Madh, gjithë ditjet, kulturën dhe përvojën e tij, i ka vënë gjithmonë në shërbim të çështjeve madhore të Kombit tonë dhe domosdoshmërisë së instalimit të demokracisë të vërtetë.

Ju, zotërinj të nderuar e njihni qysh herët veprimtarinë e tij si letrare, ashtu dhe atë publicistike, e cila pasqyrohet edhe te libri i tij me poezi dhe tregime që po paraqitet sot, me titullin “Oda Dibrane”, por unë do të mjaftohesha duke kujtuar punën e tij të palodhur si kryeredaktor i gazetës atdhetare “Veterani” të OBVL - së, ku ai është edhe sekretar i Përgjithshëm. Qysh nga data e krijimit të saj, kemi pasur ndër duar plot 448 numra të asaj gazete, dhe askush, e përsëris, askush nuk ka guxuar të bëjë qoftë edhe një vrejje të vetme për asnjë nga artikujt e botuar në të apo për jetëshkrimet e figurave të shquara që shkrinë jetën e gjithçka patën për lirinë e Atdheut, dhe padrejtësitë e kohës i ndëshkuan pa e merituar. Ajo gazetë, nën drejtimin e Halilit, ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në rishkruarjen e drejtë të historisë tonë, shpesh të falsifikuar dhe me të vërteta të mohuara, sipas koniukturave politike. Si për ta

përgjithësuar këtë, vlen të përmendet fakti, se krahas modestisë të pashembullt që e karakterizonte Heroin e Pop-

ullit dhe “Nderin e Kombit” gjeneral Rahman Parllakun, ishte edhe përkushtimi i palëkundur dhe zgjuarsia e Halil Ramës, që e bëri përfundimisht atë vigan e shqiptar të madh, të dashur për këdo, dhe e shndërroi, ashtu sikurse që në të vërtetë, në simbol të mirëkuptimit, tolerancës, harmonisë e vëllazërimit dhe kurajës për të ngitur zërin burrërisht për dënimin e agresionit barbar serb, dhe për të drejtat dhe liritë e popullit të Kosovës apo të bashkimit të saj me Shqipërinë. Prandaj, në emër të shokëve

anëtarë të Degës së Durrësit të pranishëm, dhe me porosi të veteranit më të vjetër, ish Kryetarit Genc Ballanca, tani 95 vjeçar, e uroj nga zemra mikun tonë Halil Rama për jetë të gjatë e të lumtur në familjen e tij, të cilës i këndon me aq ndjenjë, edhe në këtë libër, dhe sa më shumë suksese në fushën e nderuar të krijimtarisë gazetareske dhe letrare.

**\*Fjalë përshëndetje me rastin e 65 vjetorit të lindjes dhe promovimit të librit të 30-të të Halil Ramës.**

### DEDIKIM:

## Autorit HALIL RAMA për veprën e tij të 30-të “ODA DIBRANE”



**Nga Islam VOKA\***

**M**e respektin e thellë e përulësi për punën e tij, Halil Rama ngre lart emrin e Dibrës, dhe unë i drejtohem me këto fjalë: se ju i Nderuar ju nxiti dashuria për Dibrën e vendlindjen tonë Muhurrin, që ke mbledhur tërë ato tinguj, kujtime, aromën e vjetër të odave tona e ato Dibrane në shekuj. Se çdo fjalë që lidhet me Dibrën mbar një frymë burrërie, një rrezatim zakoni e një ndjenjë krenarie që nuk e shuajti dot as koha, as luftrat, as vuajtjet e as mundimi.

Ajo odë që mblidhte dikur burrat e qëmotit, ata që ja thonin në ato oda këngës, valles sipas traditave tona, apo tingujt e fyellit, bilbilit, të çiftelisë, dajres e daulles, por dhe kuvendin e mendjen e hollë e të kthjellët të vatrave tona në çdo fshat të Muhurrit e krahinë të Dibrës, si kujtesë e përbashkët për të gjithë ne, tek ato që kanë jetuar më parë, apo dhe ne që kemi jetuar e

sot jemi me thinjat e moshës së gjithë atyre viteve që mbartim mbi supe, por përherë pa ndalur dashurinë e madhe për kulturën e artin tonë popullor sipas traditës tonë dibrane që buronin nga gurra jonë popullore...

Në rrugën e gjatë të jetës, njeriu shpesh përballet me pengje, me sprova e me keqkuptime, por mbi të gjitha mbisundon e vërteta, puna dhe qëllimi i pastër, koha e di vet si i vë gjërat në vendin e vet. Kultura dhe arti mbeten gjithëmonë ura që lidhin njerzit—se aty ku ka këngë aty shuhet çdo hije e keqe.

Edhe pse koha na ndan në mendime e rrugë, ne sot përsëri bëhemi bashkë, se dashuria për Dibrën, për njerzit e saj, për zakonet, për këngët, vallet tona e muzikën, e humorin, për fisnikërinë që buron sidomos nga mali e nga djerisa e ndershme e njeriut tonë bëhet më e bukur e më tingëlluese dhe që depërton më thellë në zemrat e çdo dibrani.

Le të mbetet kjo vepër e Halil Ramës, një dëshmi e gjallë e shpirtit dibran, që di të kujtojë, di të vlerësojë e di të mba-


jë lart atë që është e mirë por që bashkon çdo gjë. Me këtë rast, me ndjenjë të lartë përgjegjësie e mirësie, por dhe me respekt e përshëndes Autorin Halil Rama për përkushtimin e tij, duke i Uruar shëndet e frymëzim në vazhdimësi në krijimtarinë e tij, se arti më në fund është pasqyra më e pastër ku njeriu sheh veten ashtu siç është—dhe vetëm ata që punojnë me shpirt e dashuri si Halili jonë, lënë gjurmë që nuk fshihen.

Unë si një bashkëshatar e shok i kahershëm i Halil Ramës e mbyll Dëdikimin tim : Duke i Uruar 65 vjetorin e Ditëlindjes, si dhe Nderime e Urime të përzemërta për të gjithë dhe Ju të pranishëm për Halil Ramën e Nderuar, e kurrë mos ju Ndaltë ajo penë e Artë që sot na mblodhi bashkë.

**\*President i Ansambllit Artistik “DINE DODA”, Muhurr-Dibrë**

## DOSSIER

# DËSHMORI TAHIR LOSHA, I RIU QË LA GJURMË NË HISTORI..



**Nga Nexhbedin Basha  
GAZETAR & POET**

**I**shte shtator i vitit 1980! U gjenda jo rastësisht por me detyrë si mësues në fshatin Kacni. Në një vend ku mali dhe heshtja ruajnë kujtime që nuk zbehen, dhe historia është e ngulitur në çdo hap e në çdo gur.


Aty më priti një grua me dinjitet të rrallë, fisnike, Shkurte Losha, motra e Tahir Destan Loshës, “Dëshmor i Atdheut”. Nënë Shkurtja me një buzëqeshje të ngrohtë e respekt të thellë më ofroi një kafe të zier me kujdes e dashuri e misra të pjekura; një traditë që fliste për mikpritjen e trashëguar, për shpirtin e butë, por të fortë, të kalitur nga vuajtjet dhe krenaria.

Në shtëpinë e saj ndjeva menjëherë se isha mes njerëzve që kishin dhënë



shumë për këtë vend, pa kërkuar asgjë në këmbim.

Gjatë katër muajve që qëndrova në Kacni, nuk isha më vetëm mësues, por një dëgjues i vëmendshëm i historive që nuk gjenden në libra. Nga



Shkurta, nga familja Losha dhe nga banorët e zonës, mësova për jetën dhe rënien heroike të Tahir Destan Loshës – një emër që për shumëkënd është simbol i qëndresës dhe i besnikërisë ndaj idealit të lirisë.

## TRASHGIMIA E FAMILJES LOSHA. NGA FLAMURI I VLORËS TE SAKRIFICA

*- Rrëfimi i nipit, Destan Losha – trashëgimtar i i dëshmorit, një emri me peshë në histori-*

**N**ga nipi Destan Losha, që mban me krenari emrin e gjyshit, babait të dëshmorit Tahir Destan Losha, dëgjova një rrëfim të ngarkuar me ndjenja krenarie, dhimbje dhe zhgënjimi.

“Pema gjenealogjike e familjes sonë, thotë ai, përbëhet nga shtatë fëmijë: Tahiri (dëshmor i Atdheut, që ra në krye të detyrës pa lënë trashëgim), Hasani, Saliu, Rustemi, Nazifi Fazilja dhe Shkurte (Lica – Ceni). Të shtatë fëmijët ishin bijtë e Destan Loshës dhe të bashkëshortes së tij Sibe Losha, të cilët i rritën me sakrificë dhe ndershmëri, duke u përcjellë dashurinë për Atdheun.”

- Gjysh Destani, thotë nipi i tij, ka qenë pjesëmarrës i nderuar në ngritjen e flamurit në Shpalljen e Pavarsisë në Vlorë më 1912, nga Ismail Qemali. Xhaxhai im, Tahir Destan Losha ka qenë partizan i palëkundur i Brigadës V Sulmuese, me komandant Shefqet Peçi dhe komisar Hysni Kapo. Si partizan mori pjesë aktive në luftë për çlirim e vendit nga viti 1940 deri në vitin 1944.

Pas çlirimit të vendit për meritat e tij në luftë u caktua me detyrë në organet e ndjekjes, në Postën e Policisë në Qaf të Malit Pukë. Gjatë kryerjes së detyrës në përpjekje me bandat e asaj kohe, në Iballë të Pukës, në pranverën e vitit 1948, ai ra heroikisht në krye të detyrës dhe u shpall “Dëshmor i Atdheut” së bashku me kolegun e tij Vasili, vepra e të cilëve u përjetësua në këngë: Ja disa nga vargjet e asaj kënge:

“48, një ditë pranvere/ si gjithmonë edhe kësaj here/ vesh me armë e bombardu/ në Iballë të Pukës për me shku/ me kriminela janë taku/ 12’të numron Vasili/ do të vdesim i thotë Tahiri/ Kur l’shon zonin Tahir Destani/, dridhet toka e tundet mali/, kur kërcet automatiku/, vdes i gjallë nat’ pritë armiku...etj”.

Ai sëbashku me kolegun e tij Vasilin ranë si trimat me pushkën në dorë, në mbrojtje të rendit dhe të idealit të Shqipërisë së re dhe shteti shqiptar i shpalli “Dëshmor të Atdheut”.

Emrin e Tahir Losha e mban me krenari shkolla e mesme e përgjithshme “Lunarë”. Trupi i tij prehet i qetë në varrezat e dëshmorëve në qytetin Peshkopi, rrethi Dibër. Në nderim të të rënëve, në Iballë Pukë dhe nderim të dëshmorëve të Katër Grykëve, është ngritur një labidar në Selisht, Dibër, por që ka nevojë për restaurim dhe përkujdesja nga organet e pushtetit vendor.

Dëshmorit Tahir Destan Losha lindi në Kacni më

1917. Ai nuk është thjesht një emër në memorial apo mbi një shkollë, në një labidar, por kujtesë e gjallë, frymëzim për brezat e të gjitha asaj zone të “Katër Grykëve”, që u rritën dhe edukuan me ndjenjën e dashurisë për Atdheun në atë zonë.

Rrëfimi i Destanit nuk u ndal në të kaluarën, i cili u rrit me amanetin e xhaxhait. Por, ai tregoi me zë të përmbajtur një të vërtetë që i rëndon shpirtin:

- Në gjurmët e tij kam ecur gjithë jetën. Nuk kam mbajtur pushkë, por kam punuar me nder e dinjitet në ndërtimin e vepra të mëdha kombëtare, hidrocentrale, si teknik në Fierzë, Koman e Banjë deri në vitin 1999. Kam punuar me ndershmëri e përkushtim, ashtu si do të kishte dashur xhaxhai im.

Me ndrimin e sistemit, fëmijët e mi dhe unë kemi marrë rrugët e emigrimit. Me djersën e ballit kemi ndërtuar jetën tonë larg vendit.

Ai rrëfen se: “Në demokraci është i nevojshëm një emigracion për çdo person, por deri në 10 vjet. Jo emigracion të përhershëm. Pse të mos jetojnë e shkollohen nipërit e mi në Shqipërinë që e deshën të parët tanë, që na mësuan se guri i rëndë peshon në vend të vet?! Pse të punojnë për të tjerët, por jo për vendin tonë, Shqipërinë e dashur?!...Jo, jo kjo nuk është mirë. Shteti duhet të ndërtoj politika që fëmijëve të mi e të tjerëve emigrant t’u krijohen mundësi dhe baza për t’u kthyer me vullnet në vendin e tyre...”.

Sytë e Destanit ndritën për një çast, pastaj e mbuloi trishtimi:

“Si është e mundur që pas gjithë këtyre viteve, as emri i dëshmorit, as djersa jonë, të mos kenë marrë mirënjohjen e denjë dhe shpërblimin e duhur nga shteti? Pse të harrohen familjet që e ngritën këtë vend me gjak dhe krahë pune? A nuk kemi të drejtë të jetojmë me dinjitet në vendin tonë?”.

Dhe sa më shumë këto probleme nuk marrin rrugë e zgjidhjes do të rëndojnë më shumë të brezat e rinjë që janë shpresa e këtij vendit, pasi ato dhe fëmijët e tyre kanë lindur në kurbet s’ka pse të rriten e kontribuojnë në vendet e huaja.

### FAMILJA LOSHA, NJË HISTORI SAKRIFICE DHE HARRESE

Historia e familjes Losha është një dëshmi e gjallë e përkushtimit ndaj Atdheut. Tahir Destan Losha dha jetën për lirinë e vendit, por ende nuk është shpërblyer si “Dëshmor i Atdheut”. Edhe pse ai nuk la trashëgimtarë të drejtpërdrejtë, nipërit e tij

mbeten krenarë për gjakun e dëshmorit dhe kërkojnë drejtësi e vlerësim.

Destan Losha, nipi i tij, ka mbartur ndër vite këtë amanet, duke kërkuar që shteti shqiptar të njohë zyrtarisht statusin dhe shpërblimin që i takon.

“Ne nuk kërkojmë asgjë më shumë se atë që na përket – nderimin dhe kujtesën e merituar”, shprehet ai.

Është koha që Parlamenti shqiptar ta sanksionojë me ligj këtë të drejtë, duke garantuar shpërblimin financiar për dëshmorët e Atdheut – si akt detyrimi moral dhe ligjor ndaj atyre që dhanë jetën për Shqipërinë.

### “O Tahir, o fllad lirie!”

Trim i luftës, në punë dëshmor,  
Zogjëvet të maleve ju ndalet toni,  
Pushka i qëndisi kuror,  
Si trimat luftoi Tahir Destani.

Në mal e në gur...rron Tahiri  
Vikama e tij za bilbili,  
Lotin Nona nisi pahiri,  
Plag në zemër lule trandafili.

Refren:

Nipër e mbesa thurrin vargie,  
Për stërgjyshin – legjendë e gjallë.  
N’zemra t’popullit ka vend të artë,  
Flakë lirie i fortë si strallë.

Per stërgjyshin, legende e gjall,  
Nipër e mbesa kujtojn në vargie,  
Në zemër të popullit mbetesh i rrall,  
Flakë lirie, flamur ndër pragje.

O Tahir, je flake lirie,  
Re në detyrë, si të ka hije.  
Gjemoi toka u dridh mali,  
Re si burrat, Dibra zemër trim të fali.

Refren:

Nipër e mbesa thurrin vargie,  
Për stërgjyshin – legjendë e gjallë.  
N’zemra t’popullit ka vend të artë,  
Flakë lirie i fortë si strallë.

**Nexhbedin Basha  
Gazetar & Poet**


117-VJETORI

# KONGRESI I MANASTIRIT, DRITË E SHKRONJAVE QË NUK SHUHET

MEVLUD BUCI

**17 vjet** më parë, atdhetarët dhe dijetarët e flaktë shqiptarë çuan përpara veprën e Rilindasve tanë, duke vendosur alfabetin përfundimtar të gjuhës shqipe, që çoi në konsolidimin e mëtejshëm të unitetit kombëtar, bashkimin e tij politik kundër zgjedhës së huaj e synimeve shoviniste të shteteve fqinjë. Ky Kongres është dëshmi e vërtetë e një kulture të re, e cila do të ndihmonte mjaft çështjen kombëtare përmes zhvillimit të kulturës.

Në letërkëmbimin me Klubin e Manastirit për thirrjen e Kongresit të alfabetit, patriotët shqiptarë shkruanin se “çështja e abc-së është një çështje e madhe dhe na pengon shumë përparimin kombëtar, se me abc-në unike do t’u jepet një goditje e fortë shkollave dhe intrigave greke në Shqipërinë e Jugut” (ASHF. Klubi shqiptar “Bashkimi” i Manastirit, D.5fl.148). Se alfabeti unik provon se kombi jonë është



bërë një si komb”.

Iniciativa e klubit “Bashkimi” u prit me gëzim nga gjithë kombi. Në letrat që i erdhën këtij Klubi nga shoqëritë shqiptare si ajo e Elbasanit, Janinës, Shkupit, Shkodrës, Beratit, Starovës, Ohrit, nga kolonitë shqiptare të Kajros, Aleksandrisë, të Bukureshtit, të

Varnës, nga shoqëria “Besa -besë” dhe nga dhjetëra klube brenda dhe jashtë atdheut, shprehej shpirti atdhetar dhe gadishmëria për të dërguar përfaqësuesit e tyre në këtë kongres.

Fan Noli e Sotir Peci kërkuan që kongresi të mos merrej vetëm me çështjen e njësimt të alfabetit, por

edhe me çështje të tjera politike që qëndronin para kombit shqiptar. Dhe me të vërtetë, Kongresi shtroi edhe çështje të tjera të lidhura me luftën kundër regjimit xhonturk për të drejtat kombëtare të shqiptarëve.

Vendimi për thirrjen e Kongresit të Manastirit pati jehonë të madhe në shtypin evropian. Gazetat granceze, zviceriane italiane shkruanin se shqiptarët do të mblidheshin në kongres për qëllime politike, se kishin ndërmend të diskutonin çështjen e pavarësisë, dhe se problemet e literaturës ishin vetëm preteksti. (Klubi shqiptar “Bashkimi” D.17. Informacion i konsullit francez në Manastir, 23 tetor 1908).

Kongresi u hap më 14 nëntor dhe vazhdoi deri më 22 nëntor. Morën pjesë 32 delegatë me të drejtë vote që përfaqësonin 26 qytete dhe shoqëri të ndryshme shqiptare. Meqenëse çdo klub ose shoqëri kishte të drejtë të dërgonte në Kongres 2 delegatë, 32 delegatët kishin 52 vota, (disa prej tyre kishin nga dy vota). Përveç këtyre, në kongres morën pjesë edhe 18 delegatë të tjerë si pjesëmarrës pa të drejtë vote. Në këtë mënyrë, në Kongres morën pjesë 50 delegatë nga të gjithë anët e Shqipërisë. Përbërja shoqërore e delegatëve ishte e ndryshme dhe përfaqësonte përbërjen heterogjene të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, rrymat dhe tendencat e ndryshme.

Krahas demokratëve të shquar si Bajo Topulli, Çerçiz Topulli, Mihal Grameno, Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Shahin Kolonja, Thoma Avrami, morën pjesë edhe figura të ndritura si: Gjergj Fishta, Mitat Frashëri, Abdyl Ypi, Ndre Mjeda, Taqi Buda, Nyshet Vrioni, Vehbi Dibra, Sherif Langu, Hoxhë Voka e shumë të tjerë.

Çështja e alfabetit ishte së pari një çështje politike, sepse mungesa e tij ishte pengesë për bashkimin e shqiptarëve. Nga diskutimet, doli e qartë se alfabeti që do të vendosej duhej të kishite për bazë alfabetin latin. Mbi bazën e tij ishin vendosur tri alfabetet e kohës, ai i Stambollit, i shoqërisë “Bashkimi” dhe “Agimi” të Shkodrës. Edhe shumica e botimeve në shqip shtypeshin me alfabetin latin. Një propozim i Hilë Mosit ishte që të bashkoheshin tre alfabetet duke krijuar një alfabet të ri. Luigj Gurakuqi, delegat i Shkodrës dhe i Arbëreshëve të italisë propozoi një alfabet të ri, në mënyrë që të mos i thyhej zemra askujt (gazeta “Liria”, 8. x 1908). Në ditën e tretë u zgjodh komisioni prej 11 vetësh (me vota të fshehta ku bënin pjesë përfaqësues të tri alfabeteve).

Komisioni vendosi të mos merrej në vështrim asnjëri nga tri alfabetet por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e alfabetit latin, duke u dhënë shkronjave latine vlera fonetike në përputhje me nevojat e gjuhës shqipe.

Pas debateve, duke vendosur për dy alfabetet që mbështeteshin kryesisht në alfabetin latin, Kongresi i Manastirit ripohoi edhe një herë vendosmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur individualitetin e tyre kombëtar. Diskutimet, debatet vendimet e këtij Kongresi pasqyrojnë më së miri vitalitetin e korifejeve të kombit për t’i dhënë shtytje përparimit arsimor e kulturor të vendit.

## Shkolla e Viçishtit, 28 dhjetor 1944

(Nga kujtimet e Skënder Menzelxhiut)



Përgatiti për botim Sakip Cami

**M**e 27 dhjetor 1944, Fehmi Kodra emërohet mësues në Viçisht të Dibrës. Skënder Menzelxhiu në ditarin e tij, kujtime nga LANÇ, botuar në vitin 1974, faqe 51 shkruan: “Gëzimi im sot është i papërmbajtur sepse më në fund pas kaq ndërhyrjesh arritëm ta plotësojmë shkollën e katundit Viçisht me mësues. Edhe më tepër i gëzuar ndjehem sepse mësues është vëllai i shokut tonë të ngushtë, dëshmorit Siri Kodra.” Faqe 51 Shkolla e Viçishtit u inagurua me 28 dhjetor 1944. Mësuesi Fehmi Kodra më vuri në dijeni për gjendjen e shkollës. Është e para shkollë e inaguruar pas çlirimt. Musa Xheka, që i vjen ndoresh, ka rregulluar 9 banka dhe ka bërë një dërrasë të zezë me copa dërrasash të bashkuara


Fehmi Kodra ka shkuar në Dibër të Madhe dhe ka siguruar bojë të zezë për bankat dhe dërrasën e zezë. Ka shkuar edhe në Tiranë dhe ka siguruar libra, fletore dhe lapsa. Populli, inagurimin e shkollës e festoi me gëzim dhe hare. Nga curlet dhe lodrat atë ditë gjëmuan malet. Prindërit kishin marrë për dore fëmijët e tyre që fillonin shkollën atë ditë. Fëmijët e dëshmorit dhe komandantit të çetës



së Gollobordës Ahmet Cami, Dritën dhe Fehmijen, atë ditë e shoqëronte xhaxhai i tyre Kurt Cami. Ndërsa Fiqiri Cami, djali i dëshmorit Musa Cami kishte ardhur vetëm. Ndjekin shkollën e sapohapur 31 nxënës, nga këto 8 vajza. Vazhdon ditari: Me datë 4 mars 1945 shkova në Viçisht te shtëpia e Sulë Camut, sekretar i keshillit të katundit. Këtu bëmë mbled-



hjen e keshillit dhe trajtuam problemet e asistencës sociale. Më pas bëra një vizitë te shkolla ku më priti mësuesi Fehmi Kodra. Ndërsa keshilli i rinisë antifashiste me shokët Mojs Ahmet Cami, Sinan Seit Markja, Mane Rrem Cami, Shaqir Adem Cami punon shumë mirë. Të gjithë i duan këta të rinj dhe ua dëgjojnë fjalën. ... Përpjekjet për hapjen e shkollës në Viçisht kishin filluar që në vitin 1940 nga biri i këtij fshati normalisti Fasli Cami. Vrasja e tij nga fashistët italianë në prill të vitit 1941 vrau edhe këto përpjekje për hapjen e shkollës, të cilat u ringjallën e u bënë realitet vetëm një muaj pas çlirimt të vendit. Sot shkolla 9 vjeçare Viçisht mban emrin e Fasli Camit, mësuesi i parë dëshmor i Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.



## PERSONAZH

## SAKIP CAMI: Nga cikli “Ngjarje të vërteta”

## 1. Prefekti

Ishte viti 1999. Në qytetin verior kishte filluar eksodi i kosovarëve, që shpërnguleshin me forcë nga trojet e tyre. Kukësi ishte qyteti dhe qendra e parë e pritjes së tyre. Një angazhim i jashtëzakonshëm i strukturave të shtetit shqiptar. Zv. Ministri i pushtetit lokal Taulant Dedja e kishte zhvendosur zyrën në Kukës. Flinte në një hotel së bashku me shumë pushtetarë të tjerë, ushtarakë, shoferë etj.

Shumë netë të ftohta të kaluara së bashku si edhe shishe pafund konjaku të rrokëllisura për tu ngrohur. Pas mbarimit të luftës dhe kthimit të kosovarëve në trojet e tyre, “tiranasi” u kthyen në kryeqytet. Zv.ministri u emërua prefekt. Hajro, një nga oficerët më të përgatitur që kishte qenë në Kukës, u lirua.

OÇ'të bënte? Pa asnjë të ardhur, me fëmijë të vegjël për bukën e gojës, merr çantat dhe del e shet rroba te “Rruga e Elbasanit”. Kalon prefekti me makinën e prefekturës dhe me të njëjtin shofer që kishte patur në Kukës. Dikush në rrugë i ngjan me Hajron. – Ore, Hajro ishte ai? E pyet shoferin. – Po, Hajro, i përgjigjet shoferi, e kanë liruar dhe shet rroba për të mbajtur familjen. – Kthehu, ta takojmë, e urdhëroi Prefekti. U takuan me mall. Në pak minuta folën për netët e ftohta që kishin kaluar në Kukës. – Dëgjio Hajro, nesër në ora 08.00 të jesh në prefekturë.

Të nesërmen që herët në mëngjes Hajro u gjendte prefektura. E priti shefi i personelit. Nuk është nevoja ta takosh shefin, i tha ai, sepse që tani e tutje ju do të punoni në prefekturë, në sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë. Paraqitu edhe te financa sepse të drejtat financiare të kanë filluar para 15 ditëve. Suksese!

## 2. Komandant Rustemi

Ishte viti 1975. Për mua ishte viti i tretë, viti i përfundimit të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve. Ushtria sapo kishte kaluar “pasoja” e “grupit puçist”. Në batalionin e sigurimit bëhet një gjyq model “për të marrë shembull”. Dënohen maksimalisht katër oficerë të rinj. Kërkohej disiplinë e hekurt por e ndërgjegjshme.... Në Shkollën tonë dy kursantë largohen pa leje. Alarm! Njoftohen degët ushtarake, familjet dhe pushteti vendor.

Për 48 orë kursantët u kthyen. Filloi gjyqi shoqëror si gjyq paraprak. Diskutim në organizatën e Rinisë. Në mbledhje do të merrnin pjesë një i deleguar i Komitetit të Partisë dhe Komandës si dhe një i deleguar i Komitetit të Rinisë së shkollës. Nga Komiteti i Rinisë së shkollës u caktova unë. Të gjithë ju shmangën, ndërsa unë nuk kishte nga të luaja. Në Komitetin e Partisë, komandant Rustemi tha se do të shkonte vetë. Fjala e tij ishte ligj. Mbledhja filloi e tensionuar. Kishte flamurtarë që u shprehën të prerë për përjashtim nga shkolla. Të përjashtohesh nga shkolla ushtarake do të thoshte të pushkatohej politikisht. Kjo ishte shprehja që përdorej në atë kohë.

Argumenti dihej: “Si mund të bëhet oficer dhe të edukojë ushtarët, një njeri që ikën nga fronti i luftës, nga detyra luftarake??

Komandant Rustemi, autoritar deri në madhështi u kthye nga unë dhe më pyeti: “Si mendon ti o rini? Unë ngriva dhe mbeta pa fjalë. Pa pritur përgjigjen time ai më tha: “Janë të rinj, kanë bërë gabim, por do të përmirësohen.” Përsëri heshta, ndonëse e kuptova se Ai donte ti ndihmonte. Ai i donte kursantët si fëmijë të tij.

“Ngrihu o Rini dhe tua japim dorën.” Unë u ngrita i çliruar dhe fola pa frikë e mëdyshje. Thelbi i fjalës sime ishte porosia e tij. – Po, po, tua japim dorën, foli komandanti, akoma pa mbaruar fjalën unë. Mbledhja mori kthesë tjetër. Të rinjtë kursantë bënë auto-kritikë. Ata u bënë oficerë shumë të mirë dhe shërbyen me devotshmëri në repartet e ushtrisë.

Nuk e di a e kujtojnë këtë mbledhje dhe këtë njeri që ua mbajti ndezur shpresat??



## 3. Njeriu që nuk ja mësova emrin

Në malin e Gollubicës kryheshin punime fortifikuese. Mali çahet me mina e brenda tij gjarpëronin tranche e hendeklidhje për strehimin e ushtarëve, rezervistëve e vullnetarëve. Ndërmarrja Gjeologjike, për t'iu përgjigjur planit të detyruar kishte caktuar punëtorët e saj, kryesisht vendas. Ishin minatorë profesionistë, por dihet që ky profesion për nga shkalla e rrezikshmërisë ngjason me atë të xhenjerit dhe të elektrikistit. Gabimi të kushton jetën. Kështu ngjau edhe me dy minatorë nga një fshat aty afër që u plagosën për vdekje nga shpërthimi i minave. Ishin të martuar dhe kishin nga katër fëmijë. Të parët që dëgjuan shpërthimin dhe klithmat njerëzore ishin ushtarët e ndërlidhjes, të cilët vrapuan t'ju jepnin ndihmën e parë, ndërsa ndërlidhësit e turnit njoftuan me shpejtësi Brigadën e Këmborisë së Qytetit B. Brigada urdhëroi repartin kundërajror që t'ua shkonte për ndihmë dhe ndërkohë nisi autoambulancën ushtarake dhe mjekun ushtarak Sh. T.

Mobilizova një grup ushtarësh, kryesisht shoferë dhe nën drejtimin e shefit teknik, automekanik Nekiut nxorrëm treshin luftarak dhe u nisëm drejt Gollubicës. Rrugën e bëmë me kujdes, por me shpejtësi që të arrinim sa më parë, pasi jeta e dy minatorëve ishte në rrezik. Kur arritëm ç'të shikonim? Dy minatorët ishin mbuluar nga dheu e nga gjaku. Njërit prej tyre, një gur i ishte ngulur në fytyrë dhe i kishte çarë aortën e djathtë, aortën që furnizon trurin me gjak. Gjaku vazhdonte të rridhte. Mu kujtua se gjëja e parë që duhet të bëja ishte të bllokoja rrjedhjen e gjakut.

Me gishtin e madh dhe me dy gishtat kryesorë të dorës ja ndala gjakun, por gjaku nuk duhej të derdhej kot, por duhet të shkonte në tru, ku nga minuta në minuta mund të ndodhte paraliza e tij. Këtë punë e kreu vetë, pasi nuk mund t'ua besoja ushtarëve të rinj e pa përvojë.

Qëndova në karroceri ku kishim shtrirë mbi një badanije edhe të plagosurin rëndë. Shoku i tij ishte jashtë rrezikut për jetën dhe në vetëdije të plotë. Kur arritëm në qendër të fshatit Z na priste autoambulanca e ushtrisë me mjekun dhe ndihmësmjekun ushtarak.

Ata pasi bënë disa ndërhyrje të specializuara u nisën në drejtim të spitalit të qytetit P Atë natë grupi i ushtarakëve qëndroi pranë tyre derisa rreziku për jetën kishte kaluar. Pas disa ditësh dy minatorët, tanimë të shëruar u kthyen në shtëpitë e tyre. Po kush ishin ata, si i kishin emrat, nuk e mësova kurrë.

## 4. Mora ministrin në telefon...

Ky është titulli i një poezie të Martin Cukallës, në atë kohë drejtor i minierës së kromit të Bulqizës. Martini ishte poet i lindur, me frymëzim, që kishte shkruar që në rini, por puna e vështirë e drejtorit të minierës e kishte frenuar sadopak.

Ardhja e Zija Çelës në Bulqizë në një stazh 6 muor ndikoi në rizgimin e poetit Cukalla. Rrinin me orë të tëra netëve në shtëpinë e ushtarakëve dhe diskutonin për letërsinë.

Kështu Martini largohej si pakuptuar nga stresi i punës me shumë përgjegjësi të drejtorit të minierës më të madhe të kromit në vend, të kromit që çante bllokadën.

Zijai ishte kryeredaktor i gazetës “Drita” dhe ishte komanduar një tjetër në vend të tij, por i shkonte fjala njëlloj. Në fillim botoi një cikël me poezi të Natashës, një mësuese e ardhur në Bulqizë dhe më pas nxiste pandërprerë Martinin që ta bënte gati një cikël. Dhe cikli u botua. Njëra nga poezitë titullohej: “mora ministrin në telefon”. Ministri H.Ç, anëtar i BP njoftohet për poezinë.

## AKTUALITET

# Kardiologët dhe ana shkencore e “Konferencës së vjeshtës”

NGA DR. LEONIDHA PEPPU

**P**ara disa ditësh u zhvillua në Pogradec “Konferenca e Vjeshtës”, e quajtur kësh-tu, sepse ekziston një tjetër e ngjashme, “Konferenca e Pranverës”. Këto janë të dalluara nga konferencat e rregullta që zhvillohen.

Shoqata e Kardiologjisë Shqiptare, por në to ftohen edhe bashkëkombës nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Dy konferencat e përmendura më sipër kanë veçanti të veçantë, sepse zhvillohen në mënyrë të përbashkët, me drejtim dhe pjesëmarrje të lektorëve nga një vend i përbashkët – Shqipëria, por e ndarë në dy ose katër pjesë. Megjithatë, ne do të flasim për anën shkencore të konferencës, për përgjigjet që ajo solli dhe për mësimet që morën shumica e pjesëmarrësve. Tematika ishte e gjithanshme, me përfundime të vlefshme nga lektorë të ndryshëm dhe me përvoja nga fusha të ndryshme. Vërtet, konferencat tona janë të dy shoqatave, por njerëzit aktivë që i drejtojnë ato janë profesionistë me emër, që japin ide dhe mendime për të zgjedhur temat e referimeve, në mënyrë që të jenë interesante, tërheqëse dhe shkencore, duke u dhënë mundësi mjekëve të mësojnë e të pasurojnë njohuritë e tyre. Kryetari i Shoqatës së Kardiologjisë Shqiptare, Prof. Mihal Tase, i ka dhënë besim të plotë Prof. Mimoza Lezhës, duke njohur aftësitë e saj profesionale dhe organizative. Ajo është përshtatur shkëlqyeshëm ndër vite dhe ka punuar me përkushtim për realizimin e objektivave që kërkojnë këto konferenca të rëndësishme. Një ndihmë të çmuar në këtë bashkëpunim jep edhe kardiologjia nga Kosova, përmes Prof. Gani Bajraktarit, i cili sjell dije dhe përvojë të gjerë për ngjarje të tilla.

## SEANCA E PARË

Konferenca u zhvillua në dy seanca. Drejtues të seancës së parë ishin figura të njohura të kardiologjisë shqiptare nga të dy anët e ndarjes historike – një ndarje padrejtësisht e krijuar nga historia kontradiktore dhe forca e imponuar e shteteve të mëdha ndër shekuj. Me shumë sukses, drejtues të seancës së parë ishin Prof. Mimoza Lezha, Prof. Mihal Tase dhe Prof. Gani Bajraktari, të cilët më pas morën pjesë edhe si lektorë me njohuri shkencore të admirueshme.

## TEMAT E PREZANTUARA ISHIN:

“Nxehtësia ekstreme dhe ndikimi në sistemin



kardiovaskular”,

“Arteria e heshtur – rrezik për aterosklerozë apo udhërrëfyes për dislipidemitë sipas ESC 2025”, me referues Dr. Naltin Shuka;

“Deficiti i hekurit në insuficiencën kardiakë – nevoja për korrigjim me marrjen e hekurit”, nga Prof. Pranvera Ibrahimimi;

“Trajtimi i fibrilacionit atrial me ndërhyrje”, që tërhoqi shumë vëmendje nga mjeshtri Dr. Ormir Shurdha dhe “Sëmundjet e zemrës”, të sqaruara me shumë efikasitet nga Prof. Majlinda Cafka.

Të gjitha këto tema ishin shumë interesante, u pasuan me diskutime të shumta nga salla dhe u vlerësuan për larmishmërinë dhe prezantimin e rasteve klinike. Sigurisht, pati mendime dhe sqarime të rëndësishme që shtuan vlerën shkencore të konferencës.

## SEANCA E DYTË

Seanca e dytë u drejtua nga Prof. Shpend Elezi (nga Kosova) dhe Dr. Naltin Shuka, ndërsa pjesëmarrja ndërkombëtare u pasurua me prezencën

e Dr. Teftës nga Italia. Në këtë pjesë, u paraqitën raste klinike shumë interesante, ndër të cilat:

Dr. Endri Horja prezantoi një rast të ndërhyrjes në kardiomiopatinë e dilatuar, e cila u përmirësua ndjeshëm pas heqjes së një cisti me kirurgji, duke forcuar funksionin e zemrës.

Një temë tjetër e rëndësishme dhe treguese ishte “Ndërlikimet e procedurave koronare me SAK”, e trajtuar nga Prof. Mimoza Lezha dhe grupi i saj.

Mjekët e fushës koronare prezantuan temën “Ekografia e zbrazët për zhvillimin e rrugëve aksesore simptomatike”, që përfshinte edhe sindromën Brugada, të zbuluar pas përdorimit të medikamentit Propafenon, paraqitur nga Dr. Ormir Shurdha dhe kolegët e tij të shumtë.

Diskusimet nga të pranishmit i dhanë gjallëri konferencës dhe kontribuan ndjeshëm në shtimin e dijeve, gjithmonë në funksion të përmirësimit të shërbimit ndaj pacientëve me sëmundje kardiakë.

## MBËSHTETJA FARMACEUTIKE

Duhet përmendur edhe mbështetja e kompanive farmaceutike që veprojnë në të dy anët e ndarjes shqiptare, të cilat kontribuojnë me përkushtim në zhvillimin e shëndetësisë.

Ndër to spikasin kompani të njohura ndërkombëtare si Novartis, me përfaqësuesit e saj të kahershëm Orgesa, Liljana dhe Alba, që ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të Dislipidimeve me përfaqësues në trajtim (Inclisiran). Po ashtu, Berlin Chemie, Menarini Group, Payami (i përhershëm në mbështetje), Trepharma, Bayer (me produktin Xarelto), Intermed, Viatris, Dompe, Novo Nordisk dhe të tjera, që japin një kontribut të rëndësishëm në fushën e mjekësisë, përmes ofrimit të medikamenteve cilësore dhe mbështetjes ndaj sistemit shëndetësor dhe mjekëve.

## PËRMBYLLJE

**Kisha kënaqësinë ta ndaja praninë time në këtë konferencë me miqtë e mi të kahershëm, Dr. Gëzim Hakrama dhe Dr. Matjan Kapaj. Ishte një aktivitet i frytshëm, i pasur në përmbajtje dhe me vlerë të madhe për zhvillimin profesional të kardiologëve shqiptarë. Shpresojmë për një të ardhme më të mirë, me bashkëpunim të vazhdueshëm, dije të përbashkëta dhe përparim të qëndrueshëm në fushën e shëndetësisë.**

\*Kardiolog

## SAKIP CAMI: Nga cikli “Ngjarje të vërteta”

(Vijon nga faja 14)

Reagimi i tij, pas sarkazmës së shokëve të tij “se ja si ta bëjnë ty vartësit” qe shumë i ashpër, por Martini ishte mal që nuk tundej. (Për hollësi pyetni Martinin dhe Zijain se unë poezitë e mija i shkruaja nga Reparti N në malin e Gollubicës dhe çdo të dielë mezi prisja gazetën “Drita”.)

## 5. Gjenerali...

Një miku im nga Tropoja më ka treguar: “Aty rreth vitit 1960 u bë një stërvitje e madhe ushtarake në Tropojë. Një grup ushtarakësh, në mes tyre një gjeneral që mbante gradën e gjeneral leitnantit dhe deytërën e zv. Ministrit të Mbrojtjes erdhi në shtëpinë tonë në Tropojë të vjetër. Gjenerali njihej nga uniforma që shkëlqente dhe shiritat e kuq e të mëdhenj.

Vëllai i madh u hapi derën e madhe të avllisë dhe i ftoi në shtëpi. -Do ta pijmë një ujë të ftohtë, tha gjenerali.

-Shpejt merr një sapllake dhe një gotë, më urdhëroi vëllai i madh. Ishim vetem ne të dy, unë dhjetë e vëllai i madh dymbëdhjetë vjeç, por duhet të

prisnim miqtë njëlloj sikur të ishte baba. -Hyp edhe në mollë e na mblidh do mollë se sapo janë pjekur, vazhdoi me urdhërat vëllai i madh.

Ushtarakët e lartë nga Tirana pinë ujë të ftohtë mali dhe hëngrën mollë me aromë mali dhe dolën të kënaqur. ...Kaluan shumë vite. Unë shkova ushtar dhe më mbajtën nënoficer në ushtri. Shërbeva jo pak, por deri kur dola në pension. Atë ditë dhjetori të vitit 2004 zhvillohej një ceremoni për 85 vjetorin e gjeneral Rrahman Parllakut. Një grupi ushtarakësh që po dilnim në pension na shpërndanë certifikata mirënjohje. Kur më erdhi mua rradha të tërhiqja mirënjohjen, ministri i mbrojtjes tha: “këtij tropojanit do ja japë gjeneral Parllaku. Gjenerali mu drejtua:

“Nga çfarë vendi në Tropojë je ?

-Nga Tropoja e vjetër, ju përgjigja unë.

-Po unë kam qenë në shtëpinë tënde në vitin 1960, kur bënim atë stërvitjen e madhe.

Cili je ti, ai që hypi në mollë, apo ai tjetri?

-Unë jam ai që hypi në mollë ...

Kishin kaluar 44 vjet dhe gjenerali mbante mend edhe detajet e vizitës së tij në shtëpinë time...

MOZAIK

# 2025 - OBVLËP, VEPRIMTARI TË LARISHME MBRESËLËNËSE

